

STUDIME E ARTIKUJ

Hasan Mekuli

EPOKA E REVOLUCIONIT DHE E LUFTËS NACIONALÇLIRIMTARE NË LETËRSITË E KOMBEVE DHE TË KOMBËSIVE NË JUGOSLLAVI

Në gjuhë të ndryshme të kombeve dhe të kombësive në Jugosllavi ekziston një thesar i tërë veprash, apo më mirë një letërsi e gjallë dhe tejet e pasur, e cila kërkon me Revolucionin Popullor dhe me Luftën Nacionalçlirimtare. S'do mend kjo letërsi s'mund të përfshihet, as përafërsisht, me një vështrim, e aq më pak të komentohet dhe të përimitohet në një hapësirë të kufizuar. Kemi të bëjmë me një periudhë kohe pesë-gjashtë dekadash më pak apo më shumë të frytshme, por tejet dinamike dhe të përmbushura me një krijimtari letrare të plotë, me rezultate të nduarnduarshme dhe të veçanta artistike. Ato, doemos, kërkojnë një vështrim dhe studim të thelluar, aq më tepër pse kemi të bëjmë me një koherencë ideoartistike të kushtëzuar nga koha, por edhe me ndryshime të mëdha, madje edhe me një kompleks kontradiktash të llojit të vet, të cilat edhe kërkojnë një vrojtim të thelluar e të mirëfilltë nga distanca gjysmëshekullore dhe nga aspektet e ndryshme. Me fjalë të tjera, ato kërkojnë një mprehtësi dhe precizitet artistik dhe historik, si dhe një analizë sociologjike artistike, me mbështetje jo vetëm në njohurinë e veprave përkatëse artistike, por edhe në njohjen e rrethanave në të cilat u krijuan, në njohjen e studimeve dhe të vlerësimeve konkrete, të cilat ndonjëherë edhe nuk përkojnë njëri me tjetrin, por janë gjykime të diferencuara, madje edhe kontradiktore.

Sido që të jetë, ky thesar veprash tërheq vëmendjen dhe, gjithnjë e më shumë është objekt studimesh, vrojtimesh nga këndet e ndryshme, madje edhe polemikash. Kjo nuk është për t'u çuditur. Kemi të bëjmë me një letërsi e cila, për nga koha kur është krijuar, për nga fryma që ka dhe për nga temat e motivet interesante kryengritëse që shtjellon, përkon qoftë drejtpërdrejtë qoftë tërthorazi, me të gjithë njerëzit e kohës dhe hapësirës së këtij vendi; është e lidhur me Revolucionin Popullor dhe me Luftën Nacionalçlirimtare të kombeve dhe të kombësive të Jugosllavisë, ndaj edhe është shkruar jo vetëm serbokroatisht, por edhe sllovenisht, maqedonisht,

hungarisht, shqip dhe në një varg gjuhësh të kombësive të tjera përkatëse. Përgjithësisht, por edhe konkretisht, kjo letërsi nxiti dhe frymëzoi Revolucionin, frymëzoi luftën kundër shtypjes sociale dhe kombëtare, nxiti përpjekjet kryengritëse për një jetë e ardhmëri të re. Në të njëjtën kohë ajo vetë u frymëzua, madje thellë, nga Revolucioni dhe LNÇ dhe vazhdon ta shfrytëzojë këtë burim të pashterrshëm temash e motivesh, i cili nuk vjetrohet, përkundër faktit se kemi, jo me dhjetëra por me qindra vepra me temë e përmbajtje nga Revolucioni dhe lufta.

Ky frymëzim karakteristik reciprok në fakt është shndërruar në një vërtetësi dhe në një proces të veçantë krijues, ku fjala letrare gjithnjë shtohet, fisnikërohet dhe mbetet aktuale, jo vetëm kur kemi të bëjmë me heroizmin e luftës, dhe me traumat e paevitueshme, që sjell ajo por me kompleksitetin e të mirave dhe të këqijave, me të cilat ballafaqohet njeriu në përgjithësi në periudha të tilla. Prandaj edhe mund të nisemi nga pohimi se kemi të bëjmë me një dukuri gati unike në letërsinë bashkëkohore jo vetëm jugosllave, por edhe evropiane, mbase edhe botërore, që revolucioni dhe lufta të jenë aq të pranishme në letërsi, jo vetëm në poezi, në tregime, romane, drama, por edhe në të gjitha zhanret e tjera, duke filluar prej vjershave deri te eseu, apo prej memoareve, ditarëve dhe kujtimeve të pjesëmarrësve, deri te proza eseistike etj. dhe jo vetëm të pranishme por edhe inspirative për brezat e krijuesve të ndryshëm, të vjetër dhe të rinj, gjatë këtyre pesë dekadave të vrullshme të luftës për jetën e re, që do të thotë edhe për kulturën e re dhe për letërsinë e re.

Gjatë kësaj kohe kjo letërsi u rrit në sasi, por edhe u kullua dhe arriti nivelin e konsiderueshëm të cilësisë, ngërtheu në vete një mori temash dhe motivesh konstruktive dhe interesante, u përpoq dhe vazhdimish përpiket ta zbërthejë psikologjinë e njeriut të kohës, energjinë e atdhedashurisë së tij, por edhe kontradiktat, e jetës pengesat, ballafaqimet apo çastet e „kapërcyshme” dhe të, „pakapërcyshme të njeriut kur është në konflikt me veten. Në këtë kompleks, të pasur përmbajtjesh krijuesit gjetën mundësi të favorshme për trajtime letrare interesante, dinamike dhe të freskëta edhe për nga përmbajtja edhe për nga forma.

Natyrisht, një pjesë e madhe veprash e përpjekjesh nga ky kompleks nuk i bëri ballë gjykimit dhe vlerësimeve të kohës, ndaj mbetën përcjellëse. Mirëpo, ekziston pjesa tjetër, tejet e pasur dhe e rëndësishme, ku kemi vepra dinjitoze, madje edhe kryevepra. Kjo pjesë është e pranishme si një specifikë letrare e kësaj kohe dhe u ka bërë ballë edhe kritereve më objektive, sepse kemi të bëjmë me një krijimtari vërtet të fuqishme dhe artistikisht të kulluar, me një art letrar në shumë pikëpamje specifik edhe me përmbajtjen edhe me formën dhe idetë që na ofron. Pra, këtu nuk vlen ai rregull i dikurshëm se „muzat heshtin kur flasin armët”. Edhe gjatë stuhisë së Revolucionit dhe të luftës, të cilat shënonin përpjekjet e popujve të këtij vendi për të bërë kthesën e madhe historike, për të realizuar ndryshime më të mëdha, rrënjësore shoqërore, muzat nuk heshtën. Përkundrazi, vetëm gjatë luftës katërvjeçare u botuan afër dyqind e

pesëdhjetë vepra të ndryshme poezie, proze, dramaturgjie etj. E nëse këtij numri ia shtojmë ato që i paraprijnë luftës kryengritëse, apo ato që u krijuan menjëherë pas luftës dhe që krijohen edhe sot e kësaj dite, atëherë ky numër do të jetë shumë më i madh, të thuash i pakrahasueshëm.

S'do mend, këtë letërsi do të mund ta ndanim edhe ndryshe. Për shembull sipas periudhave, apo sipas zhanreve dhe llojeve, sipas temave apo sipas nivelit që kanë arritur etj. Mirëpo, na imponohet fakti se veçantitë e kësaj letërsie paraqiten kryesisht në tri faza të saj. E para do të ishte faza e viteve tridhjetë, e cila rrënjët i ka ndoshta më të thella, sepse filizat e saj paraqiten menjëherë pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, por në vitet tridhjetë ajo arriti kulmin e zhvillimit të vet dhe është e njohur si letërsi sociale, apo letërsia e së majtës. Faza e dytë është ajo e krijimeve autentike në territor të lirë, në periudhën 1941-1945, kur fuqitë krijuese patën një nxitje dhe frymëzim të veçantë dhe kur nuk ishte e sigurt se a do ta përfundonte ky apo ai autor veprën e tij të filluar ndoshta vetëm disa ditë, apo edhe disa orë më parë. Faza e tretë do të ishte të themi ajo më e frytshmja, e cila fillon më 1945, apo më mirë në vitet pesëdhjetë, por e cila ende nuk ka përfunduar, sepse edhe sot e kësaj dite shkruhen dhe botohen vepra dinjitoze letrare, ku paraqitet dhe zbulohet shumëçka e re, jo e një trajte, jo e njëanshme, por komplekse, thellësisht njerëzore dhe karakteristike; shumëçka që nuk është thënë deri më tash, e përkon thellë më të vërtetat historike dhe etike të Revolucionit dhe të LNÇ.

Natyrisht, ekziston ndërlidhja e fuqishme e këtyre tri fazave ndaj vetëm formalisht dhe sa për lehtësim i ndajmë. Ato paraqesin tërësinë, sikundër që koha, të thuash prej vitit 1919 e deri më sot, është e lidhur me indin e kuq të frymës revolucionare, të një etike dhe botëkuptimi me të cilin mishërohet Revolucioni në vazhdë. Prandaj edhe është me rëndësi të vëmë në pah se faza e parë, apo letërsia sociale, letërsia e së majtës letrare, e paraqitur në revistat karakteristike të asaj kohe si janë *Izraz* (shprehja), *Danas* (Sot), *Naša stvarnost* (Realiteti ynë), *Književna republika* (Republika letrare), *Umetnost i kritika* (Arti dhe kritika), *Plamen* (Flaka), *Stožer* (Shtylla) etj. u paraqit dhe drejtpërdrejt i shërbeu fazës së dytë si mbështetje krijuese dhe si bazë ideoestetike, si një fundament i spastruar ideologjik, madje edhe metodik. Letrarët pjesëtarë të LNÇ u regrutuan nga radhët e atyre që ishin bartës idesh të letërsisë sociale. Ata nuk ishin vetëm luftëtarë partizanë me pushkë në dorë, as vetëm poetë të luftës kundër okupatorit fashist, por edhe dëshmitarë të veçantë kthesash të mëdha të filluara nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Jugosllavisë, luftëtarë të zotuar të luftonin jo vetëm kundër armikut fashist, por edhe kundër shtypësve të vendit, kundër çdo gjëje konzervatore dhe të prapambetur, qoftë në jetë qoftë në etikën dhe vetëdijen e individëve.

Faza e tretë e kësaj letërsie, mbase më karakteristikja kur është fjala për sasinë e veprave të krijuara, por me ndryshime të mëdha kur është fjala për metodologjinë krijuese, për stilizimet, potencialin, këndvështrimet, vetëm deri diku varet dhe ndërlidhet me dy fazat e para por megjithatë

është një vazhdë letrare e tyre e cila për fundament ideologjik dhe mbështetje ka pjesën më të kulluar artistikisht të dy fazave të para.

Natyrisht, kemi autorë të cilët bëjnë pjesë në tri fazat dhe vepra e të cilëve i shpreh dhe mishëron të gjitha ndryshimet ideoestetike, por edhe koherencën letrare. Ata tanimë i takojnë traditës letrare në kuptimin më pozitiv të fjalës. Mjafton të përmenden vetëm disa syrësh si Branko Qopiqi, Skender Kulenoviqi, Vlladimir Nazori, Oton Zhupançiqi, Miroslav Kërlezha, Ivan Goran Kovaçiqi etj. të cilët nuk mbetën në një, por ndërlidhin dy apo edhe të tri fazat e kësaj letërsie.

Pos kësaj, duhet të kihet parasysh edhe fakti se autorët e këtyre tri fazave u mbështetën dukshëm dhe mësuara nga fryma liridashëse e letërsive të kombeve dhe të kombësive të Jugosllavisë, nga autorët si janë Njegoshi, Mazhuraniqi, Ivan Cankari, Petar Koçiqi, Aleksa Shantiqi dhe një varg të tjerësh, si dhe nga Petefi, Adi, Vershmarti etj. të hungarezët, apo nga Naimi, Çajupi, Mjeda, Migjeni, etj. kur kemi të bëjmë me pjesën që u shkrua në shqipen dhe ndërlidhet me traditën tonë letrare.

Qoftë ta vështrojmë si tërësi, qoftë në faza të veçanta, qoftë në ndonjë mënyrë tjetër kjo letërsi shumëfish na tërheq vëmendjen: me kompleksitetin e temave në radhë të parë, por edhe me laryshinë stilistike me frymën luftarake liridashëse, me nduarnduarshmërinë që ka si dhe me elemente reformiste, me kthesa dhe prirje për ta pasuruar formën e shprehjes etj. Mirëpo, prapëseprapë, filli liridashës i saj shihet më mirë nëse e shikojmë, veçmas sipas këtyre tri fazave karakteristike.

1.

Letërsia socialiste në përgjithsi si dhe letërsia e së majtës e cila lindi nga ajo sociale dhe në të cilën shpërtheu konflikti karakteristik për mbarë ato vite, u paraqit në kushte specifike. Ajo lidhet me letërsinë përparimtare, antimilitare, evropiane, me synimet progresive krijuese dhe politike që përkonin kryesisht me Revolucionin e Tetorit, me krijimin e shtetit të parë socialiste dhe ngadhënjimin e ideve të Leninit, me përpjekjet që bënte proletariati botëror, por edhe letrarët, si ishin për shembull Maksim Gorki, Barbysi, Lacko, Mirivilis, Kërlezha, Romen Rolani, Bernard Shou, Sinkler Luisi, Drajzeri dhe një vister të tjerësh. Mirëpo ajo lidhet me vllimet e përgjithshme të kohës dhe kushtëzohet para së gjithash nga rrethanat e krijuara sociale politike.

Me krijimin e Jugosllavisë së Versajit, „mbretërisë së bashkuar të serbëve, kroatëve dhe sllovenëve” nuk u zhdukën, por përkundrazi, u shtuan problemet sociale dhe politike, u shtua dhuna e borgjezisë hegjemoniste serbomadhe, u acaruan edhe më shumë aspiratat e grupacioneve kapitaliste serbe, kroate dhe sllovene, ngase secili e donte për vete kafshatën më të majme, ndërsa interesat antagonistë po ballafaqoheshin gjithnjë e më shumë, dhe të huajt i nxitnin dhe ushqenin grindjet edhe

më drejtpërdrejt. „Bashkimi” në fakt ishte një kompromis, me të cilin mund të shpjegohej vetëm frika përpara lëvizjes përparimtare dhe shpërthimit revolucionar të punëtorëve dhe fshatarëve. „Kushtetuta e Vidovdanit” dhe centralizmi, diktatura e Aleksandër Karagjorgjeviqit dhe intrigat e tij tinëzare, „Obznana” e famshme e vitit 1920, brutaliteti i xhandarmërisë mbretërore, lufta e paskrupull kundër Partisë Komuniste të Jugosllavisë, e cila u detyrua të kalonte në ilegalitet etj. ishin vetëm disa në vargun e mjeteve tinëzare dhe të poshtra të borgjezisë për t’i sëndërtuar planet shfarosëse që kishte ajo kundër lëvizjes punëtore, kundër ideve përparimtare, kundër lirisë dhe për shkrirjen e zhdukjen e kombeve dhe të kombësive të tjera të vendit. Trazirat në Evropë u shtuan me paraqitjen e fashizmit më 1921 në Itali dhe me shtimin e kësaj fare të keqe në Spanjë, Portugali, Gjermani, Hungari etj. Po edhe Jugosllavia e Aleksandrit, e pastaj edhe ajo e knez Pavlit aspironte fashizimin. Ndër momentet më të vështira, karakteristike për ilustrimin e këtyre rrethanave, duhet përmendur për shembull vrasjen e Stjepan Radiqit në kuvendin popullor më 1928, likuidimin e sekretarit të PKJ Gjuro Gjakoviqit etj. diktaturën e Aleksandër Karagjorgjeviqit, krizën ekonomike botërore 1929-1931 dhe jehonën e saj të madhe në Evropë dhe në Jugosllavi, zhdukjen e gjithmbarshme të „lirive demokratike” ekzistuese, shtypjen e shtuar kundër popujve të vegjël dhe proletariatit e fshatarësisë, vërshimin e kapitalit gjerman dhe italian dhe depërtimin e përhapjen e ideologjisë fashiste përmes agentëve të infiltruar kudo në Jugosllavi etj. Konkurenca dhe interesat antagonistë në mes bishave të kapitalit arritën shkallën më të lartë dhe kanosesh shpërthimi i një konflikti të tmerrshëm luftarak. Masat popullore, të shtypura dhe pa rrugëdalje nga kriza, u acaruan dhe filluan vlimet e pakënaqësive të ashpra, deri sa me të vërtetë nuk shpërthyen grevat, demonstratat e përgjakshme dhe në fund edhe lufta e tmerrshme botërore e cila solli okupimin.

Në kushte të tilla politike, krejtësisht jo të favorshme, letërsia u zhvillua duke u ballafaquar me censurën, ndalimet, persekutimet e autorëve etj. Mirëpo, duke filluar me Luftën e Parë Botërore dhe me vitet që pasuan, deri në Luftën e Dytë Botërore, letërsia e kësaj kohe nuk qëndroi anash, si e paimterësuar, por përkundrazi u angazhua drejtpërdrejt, ndaj edhe i ka të gjitha shenjat dhe veçantitë e kohës. Në të u paraqitën në mënyrë të veçantë fryma dhe karakteristikat e letërsisë përparimtare, ndikimet e letërsisë së re ruse dhe sovjetike para dhe pas Tetorit, që do të thotë e asaj letërsie, e cila në asnjë mënyrë nuk kënaqet me konstatime pesimiste dhe me paraqitjen e një jete pa perspektivë, por përkundrazi zotohet të hapë shtigje të reja jete, me shembuj të ndritur dhe me një qëndrim ndjellmirë, të hapë shtigje të reja ngjashëm si ai heroi karakteristik i Maksim Gorkit, Danko, duke ndezur zemrën e vet si pishtar apo si Pavle Vllasovi i „Nënës” së Gorkit, duke flijuar çdo gjë të veten për idealin e përgjithshëm njerëzor.

Pa marrë parasysh se në këtë letërsi, apo në këtë lëvizje letrare e politike u paraqitën kontradiktat dhe konfliktet, se disa prej letrarëve „u

kënaqën me revolucionin formal” dhe me „paraqitjen” revolucionare, ndërsa të tjerët luftuan me mish e me shpirt dhe u flijuan në luftë, se filluan të paraqiten „izmat” e ndryshëm që vinin e shkonin me modën letrare, kjo letërsi tërheq vëmendjen edhe si një dokument i fuqishëm edhe si periudhë realizimesh letrare të veçanta dhe veçanërisht të angazhuara. Vargu i krijuesve të spikatur si Miroslav Kërlezha, August Cesareci, Hasan Kikiqi, Jovan Popoviqi, Novak Simiqi, Zija Dizdareviqi, apo surrealistët si është treshi Ristiq-Matiq-Vuço, si janë Ivan Goran Kovaçiqi, Mile Klopçiqi Vjekosllav Kalebi, Ivan Donçeviqi, Bratko Krefti, Radovan Zogoviqi, Ranko Marinkoviqi, Oskar Daviço dhe një varg të tjerësh, e paraqiti në mënyrë të hapur jo vetëm rolin shkatërrues të luftës pushtuese, pakuptimësinë dhe marrëzirat e kataklizmës që nxiti kapitalizmi, por edhe atmosferën mbytëse, neveritëse të jetës së asaj kohe, fytyrën e shëmtuar të borgjezisë dhe të regjimit antipopullor monarkofashist të karagjorgjeviqve dhe nevojën e domosdoshme të luftës proletare, çlirimtare etj. Në këto vite u shkruan dhe u botuan veprat letrare me peshë të veçantë artistike dhe sociale, si janë ato të M. Kërlezhës, Prezhihov Vorancit, Anton Ingoliçit, Mishko Kranjecit etj. të cilat dëshmojnë dukshëm për karakteristikat e realizmit të ri, për depërtimin e frymës marksiste në letërsi dhe në jetë, për botëkuptime të reja dhe synime që parashihnin krijimin e një shoqërie të re.

Në veprat letrare të autorëve që përmendëm, si dhe në ato të një vargu të tërë syrësh që nuk u përmendën, u paraqit tërë kompleksiteti i problemeve sociale të kohës, tërë vrulli i dashjeve popullore, tërë dinamika e kërkesave dhe e synimeve ideopolitike të brezit të ri përparimtar, i cili haptas e shprehte urrejtjen kundër monarko-fashizmit dhe kundër borgjezisë serbomadhe, të gatshme t’i shërbente edhe vetë djallit nëse duhet, por t’i siguronte interesat hegjemoniste kapitaliste që kishte. Në këto vepra u paraqitën edhe filizat e fenomenit të llojit të vet specifik kur është fjala për letërsinë dhe artin: brenda një distance kohore relativisht të shkurtër të thuash, jo të mjaftueshme për krijimin e veprave të mëdha, u paraqit një varg veprash cilësie dhe thellësie të veçantë, të cilat tanimë askush nuk mund t’i mohonte; njëherit, krahu i letrarëve djathtistë, ithtarë të monarkisë dhe të borgjezisë, sado të favorizuar, filluan t’i humbnin lexuesit, ndërsa autoriteti i shkrimtarëve të majtë shtohet përditë e më shumë. Lufta në mes të këtyre dy rrymave jo vetëm ekzistonte, por ishte e ashpër dhe e papajtueshme. Por kjo, njëherit, nuk ishte e vetmja luftë, sepse edhe brenda këtyre dy rrymave ziente një mospajtim i cili më vonë do të shpërthejë në një konflikt të hapur dhe të ashpër, për shembull në të majtën letrare. Jo më pak ishin në grindje, madje të hutuar dhe, sa më shumë që afrohej lufta aq më shumë të trullosur, edhe shkrimtarët e së djathtës. Me një fjalë, kemi të bëjmë me një kohë e veprimtari letrare komplekse dhe të ndërlikuar, të cilën është vërtet interesant ta vështrijmë nga aspekti i asaj kohe dhe i vlimeve artistiko-letrare dhe sociale të asaj periudhe, por edhe nga aspekti i sotëm, që do të thotë nga aspekti i kontributit dhe i realizimeve të kësaj letërsie, si dhe nga ai sa mund të ishte

dhe sa u bë kjo letërsi fundament ideologjik i një letërsie të pasur dhe të gjerë, e cila filloi dhe u krijua gjatë LNÇ, ndërsa vazhdoi dhe vazhdon pa u ndërprerë edhe sot e kësaj dite.

Fillin e angazhimit të kësaj letërsie dhe fjale, apo më mirë, vazhdimësinë dhe mirëvajtjen e saj në këtë ndërkohë, doemos duhet ta shikojmë në ndërlidhje me vendimet e Partisë Komuniste (vendimet e Konferencës së Tretë, për shembull) që të forcohet ndikimi në masat më të gjera të popullit, si në mesin e fshatarëve e punëtorëve ashtu edhe ndër të tjerë, të punohet me ta nga aspekti kombëtar e klasor. Sukseset e PKJ ishin të mëdha dhe sulmuese. Kjo e trazoi borgjezinë aq sa ajo u vërsul me tërbim dhe me sulme të reja kundër lëvizjes punëtore, kundër vetëdijësimit klasor dhe veçanërisht kundër organizimit gjithnjë e më të suksesshëm të PKJ, e cila tashti organizonte manifestime unike, lëvizje zulmëmëdha dhe „tejet të rrezikshme” për shtetin borgjez. Borgjezia monarkiste bënte përpjekje që edhe ajo, sipas modelit të fashizmit italian etj., të formonte organizata terroriste kundër lëvizjes punëtore. Këto sulme i organizonte dhe nxiste regjimi. Vërsuljet bëheshin nën mbrojtjen legale dhe ilegale të xhandarmërisë dhe policisë sekrete. Kjo u pa dhe u dëshmuar plotësisht, sidomos më 1924 në minierën e Tërbovlës, ku shpërtheu konflikti i armatosur dhe ku, për të parën herë, çetat proletare u treguan të organizuara dhe të afta. Arrestimet dhe përndjekjet shumë të shpeshta që organizonte borgjezia, terrori i regjimit dhe diktatura, nuk e penguan ndikimin e PKJ dhe orientimin e saj kah Lëvizja Nacionalçlirimtare. Ajo tashti qëndronte e fortë në skenën e historisë si një fakt i pamohueshëm, si fuqi e organizuar dhe e denjë për të qenë prijëse e luftës së përbashkët të të gjitha fuqive progresive.

Natyrisht, fjala e shkruar, ajo e zhurnalistikës dhe publicistikës në radhë të parë, por edhe ajo e prozës dhe e poezisë, tashti ishte në veprim si — armë specifike dhe e fuqishme e njërës dhe e tjetrës palë: borgjezia e përdorte me të madhe kundër lëvizjes klasore dhe „të kuqëve” por edhe PKJ e kuptoi mirë rëndësinë dhe funksionin e saj, ngase ajo mund të bëhej armë edhe më e fortë për përhapjen e ideve progresive komuniste, ndaj edhe u angazhua që edhe fjala e saj e shkruar të depërtonte sa më shumë në turmën popullore. Për këto qëllime PK organizoi disa gazeta si *Komunisti*, *Bolsheviku i ri* dhe një varg të tjerash, por shfrytëzoi edhe shtypi ekzistues legal për të vepruar përmes fjalës, duke angazhuar pjesën më progresive të inteligjencës për një luftë të hapur kundër borgjezisë shtypëse antipopullore, kundër diktaturës, kundër klerikalizmit dhe propagandës gjithnjë e më të pranishme fashiste, kundër monarkizmit dhe fashizmit që po kanosej gjithnjë e më shumë; madje edhe për një luftë shpirtërore që përfshinte shumë fushëveprime dhe veçanërisht zhvillohej në krijimtarinë intelektuale, artistike dhe shkencore. Pikërisht këtu, fryma partiake, partishmëria e llojit specifik, zinte rrënjë të thella dhe po afirmohej si frymë e fjalë me veçanti, e cila mbronte të vërtetën, shtronte çështjet esenciale, si ishte për shembull çështja kombëtare dhe e drejta prë vetëvendosje, federata ballkanike,

zgjdhja realiste e çështjeve qenësore në gadishullin „më të nxehtë” dhe mirëkuptimi midis fqinjëve ballkanas etj., etj.

Prandaj, edhe duhet vënë në pah se letërisa e kësaj periudhe është tejet komplekse dhe ka një rëndësi të veçantë. Është tejet komplekse si pasqyrë kohe dhe dëshmi pulsimesh ideologjike dhe ideoestetike, ndaj nuk mund të ndahet as në „dy pole” të kundërta: përparimtare dhe reaksionare, as në dy stile eventuale apo nuanca brenda një lëvizje dhe botëkuptimi. Sepse kjo letërsi ndryn në vete shumë ndryshesa mendimi e trajtash, domethëniesh dhe stilesh. Është e përmbushur me tema e motive rezistence e lufte sociale. Është plot nuanca, kundërshtime, kundërthënie, por edhe plot synime, hulumtime, dëshira për të zbuluar dhe për ta kapur të renë, për të hequr petkun konvencional dhe për ta kundërshtuar mendimin e shtangur konservator. Qëllimi i saj kryesor ishte që letërsia dhe arti ta kenë bazën e shëndoshë sociale dhe dialektikën e vet, të përkojnë me qëllimet e larta të shoqërisë, t’i frymëzojnë dhe t’i shtjellojnë ndërmarrjet e mëdha dhe me përgjegjësi historike. Me një fjalë, mbasi që shoqëria po hynte në një fazë të re të historisë dhe bënte kthesë të jashtëzakonshme sociale, edhe para letërsisë shtrohej detyra që të jetë e angazhuar, me mbështetje të fortë në vetëdijen klasore, në korrent me ngjarjet më të rëndësishme dhe me aspiratat e proletariatit dhe të pjesës më të vetëdijshme të popullit, e cila kishte për qëllim përmbysjen e tiranisë borgjeze dhe krijimin e një bashkësie të drejtë dhe të barabartë për të gjithë popujt dhe njerëzit e këtij vendi.* Mbizotëroi, pra kërkesa që letërsia të jetë aktive, luftarake dhe e përcaktuar, e qartë dhe optimiste, me tendencë progresive, madje të jetë edhe „mjet politik dhe armë lufte kundër borgjezisë dhe diktaturës”. Prandaj edhe u paraqitën një varg veprash me motive dhe frymë sociale, siç janë ato të Mirosllav Kërlezhës *Kulisa e Dubrovnikut*, *Kisha e fshatit*, *Ankimi mbi trupin e vdekur të A. G. Matoshit* dhe shumë të tjera, të Janko Gjonoviqit *Rrëmuesit e thëngjillit*, të Hasan Kikiqit, Radovan Zogoviqit, Hysni Çengiçit, Dobrisha Cesariçit dhe shumë të tjerëve, me tema e motive fare të reja, me brendi përparimtare të theksuar, me fundament thjesht social dhe me një intonim fare të përcaktuar dhe të qartë akuze kundër regjimit dhe shoqërisë ekzistuese borgjeze. Si e tillë, kjo letërsi e ka jo vetëm peshën artistike dhe poetikën e vet specifike, por edhe përmasën e veçantë historike, rëndësinë shoqërore dhe kompleksitetin historik.

Prandaj, faza e letërsisë sociale, e cila mori trajtën e një lëvizjeje të tërë letrare dhe ideore, ndaj edhe u emërtua si *Lëvizje e Letërsisë Sociale*, ndonëse kishte një kuptim më të gjerë dhe më rrënjësor, është një dukuri dhe fenomen letrar më vete. Në studimet historiko-letrare, në trajtesa e artikuj, apo edhe në studime vëllimore zakonisht përcaktohen prerat kufijtë e saj dhe ajo vendoset në periudhën e viteve 1928-1933 kur edhe arriti klimaksin. Pra, përkon me një kohë tejet të ndërlikuar, të përmbushur me

* Le ta kujtojmë, për shembull, njërin nga shembujt më të kulluar të qëndrimit përparimtar, internacionalist, në *Këngët e Ali Binakut*, ku pasqyrohej botëkuptimi i ri dhe ndikimi i Partisë Komuniste të Jugosllavisë.

ngjarje vendimtare sociale dhe politike jo vetëm për Jugosllavinë por edhe për Evropën dhe botën, të cilat i kishte kapluar kriza e madhe ekonomike papunësia, lëngata e urisë, grushtshteti, aroganca kapitaliste, shfrytëzimi i paskrupull, agresiviteti i imperializmit dhe sidomos i fashizmit, me një fjalë parashenjat e një kataklizme të përgjithshme, e cila edhe e goditit botën pak më vonë. Duke i shfrytëzuar këto, Hitleri korri sukses në votimet e vitit 1932 dhe pushtetin në Gjermani e mori nacional-socializmi, apo më mirë fashizmi i tij. Në shkurt të vitit 1933 u inskenua ndezja e Rajhstagut dhe u organizua procesi i famshëm kundër komunistëve. Po atë vit filloi djegia publike e librave me përmbajtje progresive demokratike dhe vazhduan përndjekjet më të egra kundër inteligjencës. Të gjitha këto janë vetëm pjesë, apo episode të një realiteti dhe politike të dezorientuar evropiane, të një krize të madhe të ndërgjegjes njerëzore, të një brutaliteti plot afëra politike e morale, plot skandale dhe shpërdorime finansiare, plot dhunë, ndaj edhe plot greva dhe shpërthime të revoltës. E vetmja shpresë për ata që ëndërronin lirinë, drejtësinë dhe socializmin, ishte Bashkimi Sovjetik, ndaj të cilit ushqenin simpati të jashtëzakonshme të gjitha fuqitë përparimtare të botës. Ai ishte shpresa dhe përkrahja e lëvizjeve revolucionare në botë. Ai ishte edhe shumbull jete dhe organizimi shoqëror ku nuk kishte papunësi, ku jeta ekonomike funksiononte në favor të njeriut, ku sistemi ekonomik e shoqëror zhvilloheshin në frymë garash për të zhvilluar industrinë dhe jetën kolektive. Ai është, veçanërisht në këto vite, inkurajim moral dhe mbështetje për të gjithë ata që besonin në rendin e ri shoqëror socialist dhe vegimit të ardhmërisë i jepnin trajtën e socializmit. Natyrisht, reaksioni dhe bota kapitaliste, të frikësuar nga kjo vërtetësi e qartë dhe nga frymëzimi i grevave dhe revolucioneve prej këtij shembulli, e luftonin dhe quanin Bashkimin Sovjetik dhe socializmin „murtajë”, sëmundje ngjitëse dhe të rrezikshme, „zgjebë” dhe „zhbind”. Prandaj, duke jetuar në ethe të frikës, kjo botë përgatitet për rezistencë „kundër komunizmit” dhe shterr fuqinë kundër një rreziku që nuk ekzistonte, ndërsa mbyllte sytë përpara zhbindit të vërtetë dhe rrezikut më të madh, përpara komplotit më të ndyrë të fashizmit, i cili lirinë e botës dhe demokracinë tinëzisht dhe apriori i kishte gjykuar me vdekje. Ky rrezik u shfaq dhe filloi me gjakderdhjen e Spanjës, me Gernikën dhe masakrin në Madrid, Barcelonë, Bilbao, por as ky paralajmërim nuk mjaftoi për ta zgjuar botën...

Në Jugosllavi, po ashtu kjo kohë u shënua me atentate e tortura, me gënjeshttra borgjeze serbomëdha dhe me vënien e diktaturës. Së pari u bë atentati në Kuvendin e Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve. Bedeli i reaksionit, Punisha Raçiqi bëri atentat kundër përfaqësuesve të popullit vëllezërve Radiqi, në qershor të vitit 1928. Parlamentarizmi u shua. Filluan proceset kundër komunistëve. U vra sekretari i përgjithshëm i KQ të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, Gjuro Gjakoviqi, më 1929, dhe kështu, gradualisht u shtrua rruga për vendosjen e absolutizmit dhe diktaturës, qeverisë së gjeneralëve dhe të pushtetit personal të mbretit.

Me 6 janar 1929 mbreti Aleksandër shpërndau Kuvendin Popullor dhe shpalli pushtetin absolut dhe diktaturën, e cila i goditi rëndë të gjitha shtresat, por veçanërisht klasën punëtore, fshatarësinë dhe avangardën e tyre, Partinë Komuniste, e cila ende nuk kishte realizuar një ndikim qenësor e të duhur në masa, dhe të cilën e brenin konfliktet e brendshme dhe fraksionet në udhëheqësi. Në të vërtetë Partia që e befasuar dhe nuk ishte përgatitur mjaft me rastin e shpërthimit të diktaturës dhe organizimit të dhjetëra proceseve kundër komunistëve (më se tetëdhjetë procese në periudhën e shkurtër prej vitit 1929 deri më 1932), ndërsa regjimi diktator i mbretërisë monarko-fashiste e tregonte gjithnjë e më ashpër urrejtjen e tij kundër demokracisë, egërsinë kundër klasës punëtore dhe mëninë e pamëshirshmërinë kundër komunistëve, duke përdorur me efikasitet Ligjin për Mbrojtjen e Shtetit. Prandaj edhe shpërthenin demonstratat dhe grevat, vlimet revolucionare dhe revolta e popullit. Më 1934 u vra në Marsej absolutisti i Beogradit, Aleksandër Karagjorgjeviqi, por monarkia mbeti. Shtypi zyrtar i vendit shkruante gjithnjë e më me simpati për fyrrerin gjerman, natyrisht me porosinë e qeverisë profashiste në krye me princ Pavlin, mikun e Hitlerit, ndërsa shtypi komunist e socialist e shante dhe vinte në pah të vërtetën mbi egërsinë e nazifashizmit dhe të fyrrerit gjakpirës, demaskonte monarkinë dhe „pushtetin e dhunës e të tiranëve të Beogradit”, „zotëritë e gjithëfuqishëm të skllëverve në Jugosllavi”, „qeverinë e qenit gjakpirës, Zhivkoviçit” etj. Në këto kushe, tejet të vështira e të ndërlikuara, filluan edhe aksionet për riorganizimin e Partisë, të cilat u kurorëzuan më 1937 me ardhjen e Titos dhe zgjedhjen e tij Sekretar i Përgjithshëm i PKJ, me krijimin e një koncepti largpamës të rezistencës kundër diktaturës, me zgjerimin e kuptimit të luftës së klasës punëtore në *luftën e përgjithshme popullore* dhe *Revolucionin Popullor*, me vlerësimin e plotë të revolucionit dhe luftës civile në Spanjë dhe me solidarësinë e shquar me popullin spanjoll, sepse „Spanja në momentin e tashëm është shesh lufte ndërmjet fuqive reaksionare dhe progresive të mbarë botës”, shkruante Tito në gazetën *Proleter* (1936), se populli spanjoll, i armatosur dobët, luftonte kundër gjakpirësve solidar dhe me qëllime të përbashkëta Franko, Hitler, Musolin, ndërsa republikanët merrnin kryesisht premtime dhe „deklarata platonike të solidarësisë” nga Lidhja e Kombeve, prandaj Partia edhe organizoi shkuarjen e interbrigadistëve edhe nga trolli ynë, në frontin spanjoll dhe e mësuar nga përvoja spanjolle dhe nga ngjarjet e tjera të ngjashme, filloi të përgatitej për rezistencën e përgjithshme.

S’do mend, të gjitha këto ngjarje të mëdha e të ndërlikuara shoqërore dhe ideopolitike, brenda apo jashtë suazave të vendit, të cilat paralajmëronin një periudhë të vrazhdë dhe përmbysëse dhe ishin në fakt „gërç” i fundit i rezistencës së botës kapitaliste, rojaliste dhe monarko-fashiste, agresivitet i çmendur i shoqërisë që po rrënohej, në njërën anë, dhe njëherësh paralajmërim i kthesave të mëdha shoqërore që po realizoheshin sipas shembullit të madh revolucionar të Tetorit të Leninit, vazhdimësi e

revolucionit botëror që s'mund të ndalej dot, përkundër kompleteve dhe pengesave të mëdha e gjakpirëse, në anën tjetër — u shprehën qartë dhe patën ndikim të dukshëm thuaja në të gjitha trajtat e aktivitetit kulturor, veçanërisht në krijimtarinë artistike, letërsinë, publicistikën dhe zhurnalistikën e kohës, që do të thotë në opinionin publik në përgjithësi, në formimin ideor e politik, në vetëdijësimin dhe krijimin e botëkuptimit fare të ri te njerëzit përgjithësisht dhe te brezat e reja veçanërisht. Prandaj edhe lindi dhe la gjurmë padyshim të dukshëm veprimi *Lëvizja e Letërsisë Sociale*, fryma ideoestetike e së cilës është krejtësisht e re për nga koncepti, ndonëse ndërlidhet me përpjeket e mëparme revolucionare e patriotike në krijimtari, frymë e majtë, socialiste dhe komuniste, që do të thotë — krijimtari artistiko-letrare e angazhuar, mbase e krijuar sipas modelit të letërsisë sovjetike dhe në frymën e realizmit socialist, por edhe origjinale, frymë dhe orientim problemi themelor krijues i së cilës është çështja e *t e n d e n c ë s*, e përmbajtjes dhe përkatësisë ideore me probleme të thuash ditore të kohës dhe të luftës që po zhvillohej në të. Kjo u shpreh dukshëm, sidomos me shpalljen e qëndrimeve të hapta të ithtarëve të kësaj rryme se — letërsia duhet të jetë ndërgjegje e kohës, pra: luftarake; ajo duhet ta përkrahë dhe ta frymëzojë luftën kundër tiranisë dhe shtypjes, të jetë vetëdija dhe udhërrëfyese ideor në rrugën e re të popullit, në parapërgatitjen e kthesës së madhe dhe t'i shërbejë në çdo pikëpamje Revolucionit Popullor. Natyrisht, kjo kushtëzoi kundërshtime e mospajtime, jo vetëm te armiqtë e revolucionit e përparimit, por edhe brenda vetë lëvizjes. Prandaj edhe u shfaqën, u shtuan dhe u bënë të thuash stil i këtyre viteve: grindjet intelektuale, mosmarrëveshjet, polemikat brenda lëvizjes,* apo lidhur me parimet e saj. Natyrisht, letërsia ende nuk kishte fuqi të mjaftueshme për të ngërthyer në vete të gjitha temat dhe çështjet serioze e të mëdha të kohës, por megjithatë edhe në teori edhe në realizime të poezisë, dramës, prozës romaneske apo tregimtare, si dhe të kritikës, ajo e dëshmoi plotësisht pulsimin dhe ndërlikimet e kësaj kohe. Vazhduan të dalin revista të reja letrare, të vëzhgohen çështjet teorike krijuese nga

* Grindjet në të „majtën letrare“ nuk ishin të pakta. Përkundrazi, ato morën përmasa të mëdha, madje edhe të dëmshme për përhapjen e lëvizjes. Prandaj Komiteti Qendror i PKJ ia besoi, si detyrë tejet delikate, pikërisht Titos zgjedhjen e kësaj çështjeje. Kontesti përkonte me qëndrimin se ç'rol dhe ç'kuptim duhet të kenë letërsia dhe arti. Kjo ndërlidhej më shumë me kontestin e përgjithshëm në mes surrealisteve dhe shkrimtarëve sovjetikë. Më 1930, në Harkov, në tubimin e shkrimtarëve revolucionarë, u përcaktua e ashtuquajtura „vija harkoviane“ lidhur me krijimtarinë letrare. Në të njëjtën kohë, kryesisht në Francë, vepronte edhe grupi i surrealisteve, Andre Bretoni, Lui Aragoni etj. rreth revistës *La Revolution surrealiste*. Këta, ndonëse e praninin domosdoshmërinë e sintezës së artit dhe të revolucionit, si edhe shkrimtarët sovjetikë, e sulmuan dhe mohuan letërsinë sociale. Ithtarët e „vijes harkoviane“ për këtë shkak i hynë qërimin të hesapeve me surrealitet dhe konflikti mori përmasa të gjera. Kjo u shpreh edhe në jetën letrare në Jugosllavi, pikërisht në të „majtën letrare“. Ndonëse shkrimtar i majtë, M. Kërlezha kritikoi vijën e ashtuquajtur harkoviane, ndaj u sulmua ashpër nga Millan Durmani dhe shkrimtarët e tjerë të majtë, ithtarë të parzervë të sintezës së Revolucionit dhe artit. M. Kërlezha u përgjegj dhe polemika u nda duke krijuar një jokënaqësi në radhët e revolucionarëve, të cilët e vlerësuan se ajo mund të jetë e dëmshme për lëvizjen, ngase zhvillohej në një kohë kur PK dhe lëvizjes i kanoseshin rreziqe të shumta nga ë djathta dhe kur lypsej një unitet dhe organizim më i vëmendshëm. Natyrisht, Tito i hyri kësaj çështjeje me seriozitet dhe, pas takimeve me të dy palët, paraqiti raportin, i cili është një nga dokumentet e rëndësishëm për vlerësimin e raportit Partia-krijimtaria. Polemika, pra, u vlerësua si një „aksident jo i pëlqyeshëm“ dhe mori fund. Mirëpo, rrënjët e këtij konflikti ishin të thella dhe ato, edhe në përmasa jugosllave edhe në ato botërore, janë edhe sot aktuale. Ndërkaq, qëndrimi i Partisë dhe i Titos për ta ruajtur dhe për ta mbrojtur M. Kërlezhën, asokohe të sulmuar nga të gjitha anët, sidomos nga klerikalizmi dhe reaksioni, ishte i drejtë dhe pa

aspekti i partishmërisë, të vështrohen dhe të diskutohen problemet e rolit të letërsisë në shoqëri në përkim me vlerësimin dhe „përjetësimin letrar të letërsisë”, apo me vlerësimin dhe „përjetësimin shoqëror e ideor”, të saj që do të thotë se tashti sërish, në kushte specifike, nisi, apo më mirë vazhdoi dueli në mes „modernistëve” dhe itharëve të lëvizjes sociale në letërsi në një rën anë, dhe në mes dy palëve, apo dy botëkuptimeve mbi letërsinë brenda vetë lëvizjes në anën tjetër. Natyrisht, në etapën e parë letërsia sociale në Jugosllavi ishte nën ndikimin e drejtpërdrejtë të *Asociacionit Rus të Shkrimtarëve Proletarë* dhe të programit e të praktikës së tyre, prandaj edhe ishte „arenë e luftës politike”, që do të thotë se ishte „dukshëm pragmatike”, ani pse ekzistonte qëndrimi i prerë se letërsia, sado që të jetë e angazhuar dhe „tendencioze”, në shërbim të luftës së proletariatit kundër diktaturës serbomadhe si një armë specifike dhe e fuqishme, medoemos duhet të mbetet *letërsi*; se assesi nuk guxon t'i mungojë petku i denjë artistik, po ashtu sikundër që si „letërsi letrare” nuk guxon të bjerë në rrafshin e artit dekadent dhe të konceptcionit të larpurartizmit. Ky natyrisht ishte vetëm një nga faktorët.

Faktori i dytë pa dyshim përkon me veprën e madhe, guximin dhe qëndrimin e Mirosllav Kërlezhës sidomos në dy fazat karakteristike të krijimtarisë së tij: atë të „fazës së revistës” *Flaka (Plamen)*, më luftarake, dhe atë të fazës së revistës *Republika letrare (Književna republika)* më analitike dhe më të kulluar. M. Kërlezha që me veprat e para u paraqit si një demaskues dhe stigmatizues i pakompromis i mikroborgjezisë, i glembajzmit dhe i trajtave të ndryshme të hipokrizisë borgjeze, i absurditeteve të llojllojshme në jetën sociale, i shtypjes, abuzimeve si dhe i filistinëve mikroborgjezë, të cilët i jepnin krah diktaturës, demaskues i bishave në pushtet që synonin „ta burgosin tërë popullin”, i një realiteti grotesk në çjerrjen e maskave të të cilit ky autor u paraqit si mjeshtër i rrallë dhe autor i furishëm dhe guximplotë. Veprën e tij e karakterizonte vendosmëria, mprehtësia kritike, patosi i lartë dhe pasioni i angazhimit, në radhë të parë *estetik*, e pastaj edhe social. Në vitet tridhjetë ai pa dyshim ishte një nga krijuesit më aktivë dhe më të frytshëm. Pos publikimit të pandërprerë të veprave nëpër revista, në këto vite ai i botoi dhe ribotoi veprat më të fuqishme, si janë cikli i dramave për Glembajevët (*Leda, Në agoni, Glembajët*), romanet *Kthimi i Filipi Llatinoviqit, Banketi në Blitva*, etj. përmbledhjen e poezive kajkaviane *Balada të Petrica Kerempuhut*, një varg esesh dhe polemikash etj., të cilat i filloi, apo i shkroi më heret, por vazhdoi t'i ripunonte dhe plotësonte gjithnjë. Secila vepër e tij është një mozaik i artit, një studim i thellë i fenomeneve të kohës, një art kompleks ku janë përfshirë e studiuar të gjitha temat e reja, problemet dhe dukuritë, kështu që për veprën e tij mund të themi pa rezervë se është një tablo jashtëzakonisht e gjerë ku paraqiten të gjitha ngjarjet, e tërë gjendja dhe filozofia e realitetit.

Ndonëse shkrimtarët e majtë e lëvdonin dhe mburreshin sinqerisht me M. Kërlezhën. në mes tyre dhe M. Kërlezhës për arsye objektive u

krijua një distancë. Rrethanat sociale në kushtet e diktaturës ndryshuan shumëçka. U krijua një situatë dhe atmosferë specifike, shoqërore në të cilën u ndalua shtypi i majtë, përndiqeshin komunistët e marksistët pa asnjë mëshirë, u pengua lufta ideologjike e politike. Letërsia, sociale në këto kushte të veçanta, dhe të papritura mori mbi vete edhe ato detyra që faktikisht nuk i takonin drejtpërdrejt, ato të cilat më parë i kryenin njerëzit dhe trajtat e tjera të aktivitetit intelektual dhe ideopolitik. Kështu, letërsia sociale vlerësohej nga ithtarët e saj si një „sintezë e artit dhe e revolucionit”; për hirë të idealeve të revolucionit dhe të humanizmit letrarët sakrifikonin, zbritnin nivelin e shprehjes dhe u jepnin veprave të veta një frymë tjetër, të cilën kundërshtarët e morën dhe e vlerësuan si „jashtëletrare”, madje edhe banalizuese. Natyrisht M. Kërlezha prore kishte një koncept, të veçantë krejtësisht tjetër.

Kundruall kësaj letërsie, qoftë në suaza të vendit apo në Evropë, ekzistonte edhe ajo e „shumë stileve” dhe e „shumë kërkimeve” që ecnin në rrugën e mohimit të arritjeve të deriatëhershme dhe të zbulimit të një „rruge fare të re”, letrare të një forme të panjohur. Këtë letërsi e karakterizonin „tiparet evropiane” si mohimi, cinizmi, lodhja, trajtimi psikologjik dhe ndjenja e pashpresë, synimet për të „ndryshuar formën” apo për ta marrë pikërisht formën si esencë të çdo gjëje etj. Prandaj edhe u paraqitën rrymat si: *dadaizmi*, mbase shprehje më ekstreme e bredhjeve të asaj kohe, ku „u mohua çdo kuptim i çdo lloji të poezisë”, me përfundim se poezia është vetëm „një grumbull termash rastësisht të hedhura në letër”, të cilat „harmonizohen” në njëfarë muzike të veçantë dhe „të palogjikshme” etj.; *si surealizmi*, i cili poashtu kishte komponentet e veta specifike: mbështetjen totale në teorinë e frejdzizmit mbi ndërdijen dhe rolin që ka ajo në veprimet e njerëzve, mohimin e të gjitha vlerave artistike dhe ideore që ka arritur borgjezia deri në atë kohë, pohimet mbi „automatizmin e të shkruarit”, mbi rolin e veçantë të ëndrrës në poezi, mbi rolin e kombëtares në art e letërsi etj. e pastaj *ekspresionizmi*, *futurizmi*, *imazhizmi* dhe një varg teorish e stilesh të tjera letrare. Ndonëse tipari kryesor i këtyre rrymave ishte zhgënjimi dhe ikja nga realiteti, ato shënuan etapën e re në letërsinë e popujve të Jugosllavisë, ngjashëm si në vende ku kishin zënë fill, dhe u paraqiten si veçori kohe, stili i kërkimeve të reja estetiko-letrare ideopolitike (në përkim me letërsinë), apo estetizante. Mbështetja kryesore e krijuesve të këtyre rrymave ishte kryesisht teoria e frejdzizmit mbi ndërdijen dhe rolin e saj në veprimet e njerëzve, si dhe kompleksi i tërë i çështjeve që përkonin me psikologjinë individuale etj. me teorinë e Bergsonit mbi evolucionin krijues, me atë të Shpenglerit mbi „përmbysjen e Perendimit”, me estetikën e Kroçes dhe me një varg teorish e mendimesh të tjera të kohës, të cilat ndërlidheshin dhe përkonin me letërsinë, drejtpërdrejt apo tërthorazi. Ikja nga realiteti, paraqitja e „disfatave” në jetën shoqërore, mbyllja në „mozaikun e fjalëve” dhe në bukurinë e „shkëlqimit të tyre të mermerit” po ashtu ishte „një trajtë e rezistencës”, që paraqitej si ind i veçantë që nga Lufta e Parë Botërore, e cila edhe i

shkaktoi zhgënjimet dhe pesimizmin në vazhdë. Mirëpo, vrulli i kohës, shqetësimet e mëdha sociale dhe rreziku permanent që po i kanosej njerëzimit nga shumë anë, dhe sidomos nga nazifashizmi, kërkonin trajta më të prera dhe më të vendosura të rezistencës dhe të organizimit ideor.

Lëvizja e letërsisë sociale u krijua dhe veproi si një këso trajte të organizmit specifik ideoestetik. Ajo u shfaq si mohim i normave të deriatëhershme dhe shprehje e mtimit që të gjurmohen, krijohen dhe afirmohen idealet e strukturave të reja shoqërore, të vihet në pah problematika sociale, të spikaten në radhë të parë aspektet klasore: shtypja klasore dhe padrejtësia, abuzimet dhe degjenerimi borgjez — të vihen në thumb të kritikës pa asnjë kompromis dhe, përmes kësaj apo në mënyra të tjera të përshtatshme që disponon fjala letrare — të zgjohet klasa e re proletare, të parapërgatitet dhe të bëhet e vetëdijshme për kryerjen e detyrave të shumta që po e prisnin. Natyrisht, shkrimtarët që përkojnë me këtë lëvizje ndryshojnë në mes veti, herë më pak herë më shumë, por nota sociale apo mbështetja e estetikës dhe krijimtarisë së tyre në bazën sociale, është tipar dhe karakteristikë e përbashkët. S'do mend, nuk janë të vogla ndryshimet në mes veprës letrare për shembull të një Rastko Petroviqit me atë të Rade Drincit, apo të Isidora Sekuliqit, as ato të veprës së Oskar Daviços, apo të Dushan Matiqit, me atë të Ivo Andriqit, etj. etj. Por është fakt se me *letërsinë sociale* kanë të bëjnë edhe këta që përmendëm, edhe Desanka Maksimoviqi, Aleksandër Vuço, Oto Bihal Merini, Branimir Qosiqi, Ivan Goran Kovaçiqi, August Cesareci, Miroslav Kërlezha, Antun Branko Shimiqi, Tin Ujeviqi, Gustav Kërkleci, Dobriša Cesariqi, Prezhihov Voranci, Dragutin Tadijanoviqi, Alojz Gradniku, France Bevku, Antun Baraci dhe shumë të tjerë, madje edhe surrealistët, sidomos grupi i Beogradit: Marko Ristiqi, Daviço, Koça Popoviqi, Aleksandër Vuço etj) të cilët, në përkim me kohën dhe ngjarjet, filluan të evoluojnë kah marksizmi, ngase marksizmi si shkencë, si botëkuptim dhe ideologji implikohej gjithnjë e më shumë në jetën shoqërore, madje depërtoi në mënyrë thelbore edhe në jetën letrare e artistike. Në vitet tridhjetë u paraqit një grup mjaft i madh krijuesish letrarë progresivë dhe anëtarë apo të afërt me idetë e Partisë Komuniste. U dalluan Jovan Popoviqi, Radovan Zogoviqi, Velibor Gligoriqi, Gjorgje Jovanoviqi, Ognjen Prica, Janko Gjonoviqi, Hasan Kikiqi, Zija Dizdareviqi, Çedomir Minderoviqi, Otokar Kershovani, Tone Selishkari, Mishko Kranjeci, Matej Bori etj. Por këta janë vetëm përfaqësuesit më të spikatur të lëvizjes, ndërsa ajo ngërthente në vete edhe një varg të tjerësh anëmbanë vendit. Krahas me ta shkruanin dhe vepronin edhe shkrimtarët „e vjetër”, ata që vazhdonin rrugën dhe veprën e tyre me frymëzime të mëparme, por ishin dukshëm të interesuar për ngadhënjimin e së vërtetës dhe për transformime sociale, të cilat do të përkonin jo vetëm me jetën politiko-shoqërore, por edhe me atë kulturore dhe letrare.

Këtu patjetër duhet të kihet parasysh fakti se letërsia sociale pati ndikim e jehonë, ithtarë dhe shkrimtarë të vet më cilëndo nga letërsitë e vendit; jo vetëm në „letërsitë e mëdha” si ajo serbe, apo kroate e sllovene,

por edhe në atë maqedonase (për shembull Koço Racini, Aco Shopovi, Bllazhe Koneski), apo në atë shqiptare që krijohet në Jugosllave (Esad Mekuli, pjesërisht Hivzi Sulejmani etj.), atë hungareze (Jozhef Debreceni dhe një plejadë e tërë rreth revistës përparimtare „Hid”) etj. Ndikimi mendor dhe ideor përmes fjalës letrare, në frymën e ideve të përparuara që përhapte Partia Komuniste, kudo ishte i madh, ndaj kudo kishte jehonë të madhe edhe polemika që bëhej në mes palëve kundërshtarë të ndryshme, në mes stileve, ideve apo synimeve ideoestetike apo sociale të ndryshme. Prandaj, doemos duhet të themi se kjo periudhë ishte tejet e ndërlikuar, me fryte të shumta, me një gjallëri e angazhim të plotë, me një dinamizëm që po i befasonte edhe vetë pjesëmarrësit. Natyrisht, kjo as nuk është e çuditshme, as nuk lë mundësinë që ta vështrojmë ndryshe pos në prizmin e parapërgatitjeve për një revolucion të madh social, në prizmin e rolit të vetëdijes kolektive dhe të partishmërisë që po i dendësonte fuqitë dhe po e frymëzonte luftën kundër regjimit diktatorial. Faktikisht, ndryshesat, kontradiktat, pasionet, kontraverzat, të gjitha elementet që u paraqitën në një varg polemikash të pakompromis, duhet t'i shikojmë si një sprovë kohe dhe shpërthim mendimesh e gjykimesh rreth letërsisë e artit, por në fakt rreth transformimeve shoqërore e politike që parapërgatiteshin dhe gjithsesi përkonin edhe me letërsinë, me fjalën e shkruar në përgjithësi dhe me artin.

Revistat që dilnin asokohe rregullisht apo përkohësisht ishin të përmbushura me lëndë që „u kallte datën kundërshtarëve” (pos revistave të M. Kërlezhës, që mbahen mend në shumë aspekte, asokohe dilnin „Kritika” e S. Galogzhës, „Mendimi social” i B. Axhisë, „Literatura e re” e vëllezërve Merin, „Gazeta letrare” e Zagrebit, „Literatura”, „Savremeni-ku”, „Knjizhevniku”, Literatura e re”, „Stozher”, „Peçat”) etj., etj. Në to gjenden shembuj të shkëlqyeshëm zotimesh dhe angazhimesh estetike e sociale fare të reja, në frymë të parimit: „Kultura në jetë, jeta në kulturë!” dhe të thirrjes së hapur që me fuqi të përbashkëta t'i shndërrojnë këto revista e gazeta në një „flakë lirie, së vërtete dhe humanizmi”, që do të thotë lufte të vendosur kundër mistifikimeve dhe gënjeshtreve që përhapeshin si pohnin këto revista në çdo anë: në jetë, në letërsi, në ekonomi, në politikë, në teatër, në artin figurativ, në shtyp dhe në mjete të informimit në përgjithësi. Këto revista, apo më mirë autorët që bashkëpunonin në to, e damkosnin pa mëshirë tërë këtë gënjeshtër të një shoqërie e cila fliste aq shumë për lirinë e drejtësinë dhe aq shumë i mbyste dhe i lidhte ato në prangat e ligjeve të veta të regjimit të diktaturës e të tiranisë. Kjo luftë bëhej në radhë të parë nëpërmjet të veprave origjinale letrare, si është për shembull „Libri i shokëve” që përgatitën Jovan Popoviqi e Novak Simiqi me shokë, kundër të cilëve u organizua në gjykim i tërë, por edhe me një varg përkthimesh të veprave letrare e filozofike të spikatura, botërore të kohës, të cilat frymëzonin rezistencën dhe shtronin detyrime, si ishin përkthimet e veprave të Anri Barbysit, Johanes Beherit, Sergej Ajnshtajnit, Maksim Gorkit, Panait Istratit, Egon Ervin Kishit, Ervin Piskatorit, Apton

Sinklerit, Sinkler Luisit dhe të një vargu të tjerësh nga letërsia sovjetike apo të tjerat. Në të vërtetë, çkado që ngjante nëpër revista përparimtare, në gazeta, në programe të botuesve si „Noliti” etj., parimisht zgjidhej sipas efektit kritik që ka, sipas fuqisë me të cilën damkos shoqërinë borgjeze dhe demaskon gënjeshttrat e saj, në një rën anë, dhe sipas aftësisë për të përhapur idetë e reja, në anën tjetër. Kjo ishte shprehje e synimeve përparimtare të kohës për të pikasur dobësitë e shoqërisë dhe regjimit antipopullor, për të demaskuar mjerimin e një klase dhe vrazhdësinë e pakicës në sistemin kapitalist, që t'i kundërvihet socializmi si sistem botëror, më i përparuar dhe sistem për të cilin luftonte proletariati botëror, i cili jo rastësisht ishte fuqi kryesore dhe më e madhe në skenën e historisë. Prandaj kjo letërsi, sidomos poezia, zhvillohej në mënyrë specifike, në një jetë letrare dhe ideopolitike plot dinamizëm, plot kontradikta, kundërshtime, polemika, vrull besimi dhe pasion lufte për qëllime të caktuara; dhe zhvillohej kryesisht si akuzë e vendosur dhe komplekse kundër shoqërisë. Nga kjo edhe buroi botëkuptimi i ri mbi letërsinë, i cili e luftonte jo vetëm akademizmin dhe frazologjinë boshe, por edhe thjeshtësinë, banale apo më mirë thjeshtësimin e qëllimeve të artit deri te rrafshi i deklarativizmit, ndërsa propagonte idetë dhe synimet krijuese që bazoheshin dhe përkonin me botëkuptimin marksist.

Pjesa dërmuese e revistave dhe veprave letrare të krijuara në gjirin e kësaj lëvizjeje letrare, si dhe ajo vetë, si dukuri e fenomen letrar në vetë, e kanë shprehur dukshëm pakënaqësinë me gjendjen dhe me raportet ekzistuese. Kjo pakënaqësi oscilonte: prej kritikës së fshehur, të thënë me gjuhë ezopiane, deri te kritika dhe pakënaqësia e haptë, te sulmi guximplotë dhe demaskimi i regjimit të urryer të diktaturës së Karagjorgjeviqve. Natyrisht, regjimi „mbrohej” me gjykime të vrazhda, me përndjekje, me burgje, me dhunë e me gjakpirësi. Por zjarri i ndezur njëherë s'mund të shuhej dot. Ai përhapej gjithnjë e më shumë, në mbarë vendin. Socializimi i letërsisë në ato ditë spikaste vërtetësinë se letrari duhej të ishte mu në qendër të realitetit dhe të ngjarjeve, se letërsia duhej të ishte shprehje e vetëdijes klasore dhe se letrari nuk mund të ishte vetëm shkrimtaar, por duhej të ishte edhe luftëtar për transformimin e shoqërisë, sepse, doemos edhe letërsia është një prej burimeve të mëdha të „fuqisë së popullit”, ajo që e frymëzon, e jo vetëm ajo që argëton. S'do mend, kjo lëvizje letrare e kulturore kishte edhe dobësi, kontradikta, lëshime etj., por, pa asnjë dyshim, roli i saj që i madh për zbërthimin e raporteve ideore dhe estetike, për botëkuptimin revolucionar të letërsisë dhe për vazhden e rrugës së fjalës letrare në ditët e stuhive të luftës. Kjo u pa sidomos në vitet 1937-1941. Por ngjyrat dhe ndikimi i kësaj letërsie shihen edhe më vonë. Lëvizja përfaqësonte diçka krejtësisht të re në aspektin letrar dhe mendor, ndaj edhe pati shumë ithtarë si dhe kundërshtarë, të cilët, në të dy rastet, ishin figura karakteristike të kohës, të mendimit apo të stilit të luftës për një të ardhme tjetër të letërsisë dhe të jetës. Nga vetë ky fakt shihet se kjo lëvizje që një shfaqje karakteristike, por edhe e ndërlikuar, komplekse,

sidomos kur e kemi parasysh faktin se ajo, nga aspekti ideor dhe estetik, shtriu ndikimin e vet edhe jashtë periudhës së intensitetit të vet, madje deri në vitin 1952, të cilin Stanko Llasiqi, në studimin e tij *Konflikti në të majtën letrare 1928-1952*, e përcakton si kufi dhe vit përfundimi.

Sidomos që të jetë, fjala letrare gjatë kësaj lëvizjeje, si edhe e tërë lëvizja e letërsisë sociale e cila ishte shprehje e natyrshme e kohës, që në shërbim të synimeve përparimtare, të transformimit shoqëror dhe të revolucionit. Kryengritja e armatosur që përgatitej, Revolucioni Popullor dhe lufta kërkonin që edhe letërsia të ishte militante, aktive në këto procese, dhe ajo vërtet që mjaft efikase në sendërtimin e qëllimeve të revolucionit.

2.

Me okupimin fashist erdhën ndryshimet rrënjësore në të gjitha sferat e jetës. Derisa okupatori gjermano-italian përpiquej të krijonte sa më shumë aleatë në radhët e kuislingëve dhe të borgjezisë së vendit, ta shfrytëzonte fuqinë e tyre për luftë kundër komunistëve dhe të gjitha forcave përparimtare, të cilat nuk u pajtuan dot me okupimin e vendit, PK arriti ta organizonte popullin e ta çonte në kryengritje të përgjithshme popullore kundër okupatorit. Kryengritja i përfshiu të gjitha shtresat shoqërore, të gjitha kombet e kombësitë. Partia i provoi aftësitë organizative dhe dëshmoi largpamësinë e vet pikërisht me qëndrimet e para revolucionare e luftarake, me parashikimin e zgjidhjeve të drejta të çështjeve rrënjësore për një jetë në bashkësinë e shëmtuar të ardhshme socialiste, si ishte për shembull çështja esenciale kombëtare, apo ajo agrare si ishin bashkimi e vëllazërimi, e drejta sociale, që nënkukpton të drejtën e punës, lirinë, zhvillimin kulturor etj. U pa menjëherë se PKJ ishte jo vetëm prijëse e vërtetë, por edhe e vetmja fuqi që mbron interesat e vërteta të popullit, lirinë dhe pavarësinë e vendit dhe të njeriut e zonja për të krijuar ardhmërinë e barabartë për të gjithë. Revolucioni nxiste fuqinë krijuese, ndaj edhe fjalën letrare. Proceset e filluara në mes dy luftërave vazhduan tani në kushte tejet të vështira, por me elemente specifike dhe me domethënie të lartë ideore. Ngazëllimi revolucionar i popullit tashti shndërrohej në një potencial specifik krijues. Krijonte mbarë populli, kështu që fare natyrshëm lindi një letërsi popullor luftarake, tejet origjinale dhe karakteristike, epike e lirike, shprehje e drejtpërdrejtë e mllefrit dhe krenarisë, e hidhërimeve në ballafaqim me vdekjen dhe e gëzimeve pa masë në takime me lirinë, me territorin e lirë gjithnjë e më të zgjeruar. Kjo letërsi, edhe me sasinë e madhe dhe me cilësinë e vet artistike, me thellësinë epike apo me njomësinë e lirismit, jep mundësi të shumta për aspekte të ndryshme të studimit etik, revolucionar, estetik etj. Ajo pa dyshim është histori specifike e një populli, apo më mirë — histori kryengritjesh të njëpasnjëshme të popujve e kombësive të mbarë vendit. Ajo është shprehje e papërkulshmërisë dhe e krenarisë së një „populli të njohur si popull i paepur”. Por, kjo nuk mbetet me kaq. Krahas me popullin këngëtojnë, shkruajnë dhe luftojnë shkrimtarët më të

spikatur, në territor të lirë, në vijën e zjarrit, aty ku takoheshin jeta dhe vdekja, aty ku mund të ballafaqohesh me skëterrën e vdekjes apo me diellin jetësor, apo në prapavijë, ku po ashtu djajtë kishin krijuar ferrin, ndërsa populli dhe fuqitë progresive ilegale e luftonin.

Fjala letrare gjatë këtyre viteve korri fitore të mëdha. Ajo u paraqit si trime e vërtetë dhe vazhdë e denjë e traditave atdhetare të një vargu shkrimtarësh të brezave të përparshëm, fjala e të cilëve tashti qëndronte e ringjallur në mendjen dhe ndjenjat e çdo partizani. Luftëtarët shoqëroheshin me Njegoshin e Shantiqin, me Kranjçeviqin e Nazorin, me Mazhuraniqin, Jakshiqin, Preshernin, Zmajin dhe me një varg shkrimtarësh të gjallë apo të vdekur, të cilët tashti qëndronin me fjalën e tyre poetike në vijën e zjarrit, në sheshin e luftës për liri. Letrarët dhe letërsia në fakt tash po shkonin „në rrugën e vështirë dhe të shenjtë të humanizmit dhe të lirisë” si thoshte V. Nazori. Shumica e letrarëve të letërsisë sociale në mes dy luftërave, shumica e krijuesve përparimtarë, u gjenden në radhët e partizanëve. Sepse kjo ishte në radhë të parë luftë kundër okupatorit, por edhe kryengritje e përgjithshme dhe luftë kundër borgjezisë dhe kapitalizmit kundër çifligarëve dhe tregtarëve me flamuj e shpirtra. Ky ishte Revolucion i Përgjithshëm Popullor që luftonte për lirinë kombëtare e sociale, për sendërtimin e idealeve dhe të bashkësisë socialiste, demokratike dhe të barabartë për të gjithë. Nuk është pra çudi pse pikërisht në këtë luftë e rrugë e provuan besnikërinë e tyre ndaj popullit, atdhetarizmin dhe botëkuptimin përparimtar, pos krijuesve të tjerë edhe shkrimtarët e dalluar nga të gjitha kombësitë si: Vlladimir Nazori, Ivan Goran Kovaçiqi, Jovan Popoviqi, Radovan Zogoviqi, Mihaillo Llalliqi, Veselin Maslesha, Vjekosllav Kalebi, Gjorgje Jovanoviqi, Marin Freñçeviqi, Jure Kashtelani, Koço Racini, Mishko Kranjeci, Mirko Bozhqiqi, Matej Bori, Dushan Kostiqi, Esat Mekuli, Hivzi Sulejmani dhe një varg të tjerësh më shumë apo më pak të njohur. Nuk është çudi pse ata janë bashkë me popullin dhe atje ku printe Partia Komuniste dhe pse pikërisht këtë luftë e morën si burim të pashtershëm temash e motivesh për poezinë e vet, për mbarë krijimtarinë e pastajme. Është e vërtetë e madhe se pjesëmarrja e letrarëve si ishin V. Nazori dhe të tjerët në luftë dhe në anën e partizanëve kishte një përmasë specifike, sepse ngrihej lart autoriteti moral e politik i lëvizjes partizane dhe e vërteta se ata ishin në rrugë të drejtë. E kjo kishte rëndësi të jashtëzakonshme për përhapjen e lëvizjes dhe të rezistencës popullore. Mirëpo, kjo e ka edhe përmasën tjetër. Sepse shkrimtarët kishin mundësi të ballafaqoheshin drejtpërdrejt me temat e motivet autentike, ta njohin lëvizjen partizane nga brenda dhe të kuptojnë se kjo luftë, këto vuajtje dhe trimëri, këto synime liridashëse dhe aspirata përmbysëse kundër së vjetrës ishin burim i pashtershëm frymëzimi për letrarët dhe letërsinë.

Nuk është çudi, po ashtu, pse bashkë me këta, bashkë me popullin, qëndronin me shpirt e zemër edhe shumë shkrimtarë të tjerë si Zhupançiqi, Hasan Kikiqi, Ivo Andriqi, Miroslav Kërlezha, Marian Matkoviqi, Dragutin Tadijanoviqi, etj., ndonëse nuk shkuan partizanë dhe nuk luftuan me pushkë në dorë. Veprat e tyre botoheshin ilegalisht dhe ishin prezente në radhët

partizane prore dhe kudo. Okupatori u përpoq kot t'i bënte për vete, apo t'i kompromitonte disa nga shkrimtarët. Ata në një formë apo në një tjetër ishin të angazhuar në luftë kundër okupatorit dhe fashizmit, kundër kolaboracionistëve edhe kuislingëve. Vetëm një pjesë e vogël si D. Vasiqi, S. Panduroviqi, Z. Duçiqi, M. Budaku dhe disa të panjohur në letra të kohës dhe vendit shkuan rrugës së turpfit dhe të bashkëpunimit me okupatorin.

Në kushte të luftës partizane, të transferimeve të shpeshta atje ku e kërkonte strategjia dhe puna, letrarët ishin jo vetëm letrarë, apo më mirë, jo vetëm ata që shkruanin, por edhe luftëtarë, komandantë e komisarë, redaktorë e botues të gazetave partizane, almanakëve e artikujve, ata që përgatitnin jetën kulturele dhe me të frymëzonin sukseset e njësiteve partizane etj. Shtypshkronjat ilegale dhe makinat e shkrimit s'pushonin së fabrikuari trakte e shkrime të ndryshme publiciste e letrare, përkundër tërbimit të Gestaposë dhe të kuislingëve. Ishte kohë tejet e vështirë për krijimtari e botime, por megjithatë nga fundi i vitit 1941 dhe në fillim të atij 1942 u botua almanaku „Buletini sloven” me botime të Oton Zhupançiqit, Matej Borit, Boris Ziherlit dhe të shkrimtarëve të tjerë, e ky ishte një inkurajim, një fitore e rëndësishme kulturore që frymëzonte. Në territor të lirë festoheshin përvjetorët e klasikëve Preshernit, Cankarit etj., dhe kjo ishte shprehje e dashurisë, por edhe e karakterit popullor të veprës së tyre plot ndjenja liridashëse dhe gjakim për vendin e popullin. Partia Komuniste e Jugosllavisë po realizonte Revolucionin, prandaj edhe duhej shumë dhe veprohej në të gjitha aspektet. Pra, këto veprime u paraqitën edhe në letërsi. Krijonin ata që ishin emër si letrarë, por edhe ata të cilët për herë të parë këtu po ia fillonin krijimtarisë letrare, e sish ka pasur shumë. Është gjë e njohur se gjatë katër vjetve të luftës u botuan afër 300 vepra poezie dhe dramatrugjie. Një pjesë e madhe e tyre pa dyshim nuk ka vlerë artistike të madhe, por prapë ka vlera historiko-letrare dhe dokumentare, vlerë dëshmie mbi atë se si e shoqëroi fjala letrare revolucionin dhe si e frymëzuan njëra tjetrën.

Natyrisht, nga kompleksi i madh i këtyre veprave letrare janë disa sosh që dallohen dhe kanë vlerë të përhershme letrare dhe njohëse. Ato njihen. Përkojnë në radhë të parë me poezinë, me vjersha plot tmerr e urrejtje kundër armikut, me krenarinë dhe tragjikën e jetës dhe të luftës, me qëllime të larta frymëzuese të revolucionit.

Poemave, të cilat mbase janë edhe forma më e suksesshme e letërsisë së LNÇ u prinë kryevepra e poezisë kroate në këtë kohë e pastaj: *Humnera* e Ivan Goran Kovaçiqit, e krijuar të thuash me një frymëzim, vetimthi, në fillim të vitit vendimtar për lëvizjen partizane 1943, nergut për të rrëfyer krimet dhe faqet më të zeza të luftës dhe të okupimit, për vrasjet mirore të popullit serb nga ustashët, për tërbimin dhe tmerrin e luftës në përgjithësi. Poema është sajuar si një tregim simbolik plot dhembshuri i një personazhi, të cilit ustashët ia kanë nxjerrë syt dhe e kanë hedhur në greminë, në një grumbull mish të njerëzve të masakruar. Për çudi të madhe ai shpëton dhe arrin të dalë nga ky ferr i vërtetë, ndaj rrëfen për rrathët e këtij vorbulli të zi që shembëllen me atë dantesk. E përbërë prej dhjetë këngëve organikisht të shkrira në një tërësi

poetike impulsive, *Humnera* është një poemë harmonike dhe e përkryer. Por poetikisht ajo ka karakter të ndonjë balade impulsive popullore, e cila me elementet epike dhe me gërshetime të natyrshme lirike paraqet historinë, apo më mirë fatin tragjik të njeriut në përgjithësi. Tragjika e këtij fati shihet në faktin se ai në rrethana luftime faktikisht s'është tjetër „por një fije kashte në mes stuhive”. E megjithatë ka krenari e fuqi për të rezistuar. Nuk jepet dot. Lufton dhe shpreson. I bën ballë këtij fati dhe nuk do të besojë se ky është ndonjë „fat i përcaktuar. Poeti truan e mallkon kundër fashizmit e luftës, kundër ustashevë dhe tërbimit, kundër gjesteve dhe veprimeve çnjerëzore dhe kundër atyre që fajësuan tragjedinë e përgjithëshme të popullit. Por, poema që nga fillimi është e gërshetuar me indin karakteristik të ndjellmirsisë dhe besimit të plotë jo vetëm në fitoren e dritës mbi errësirën, por edhe në njeriun dhe njerëzimin liridashës e human.

Fjala poetike e Kovaçiqit mbi LNÇ fillon me vjershën simbolike „*Kohë të errëta*”, të cilën e shkroi në Zagrebin e okupuar më 1941. Aty ai e parapa shkuarjen e vet në radhët e partizanëve, ngase „dielli është i errët, netët tepër të gjata/dhe askund ti nuk bën dritë, ylli im, /Duhet të kthehem, në mal të shkojë. /Ku zemra mund të hyjë në çdo çerdhe” ... Dhe ai vërtet shkoi, bashkë me Nazonin plak, në radhët e ushtrisë Nacional-çlirimtare, duke vërtetuar kështu se poeti i vërtetë i popullit e di rrugën e vet dhe se në çastin vendimtar ai është jo vetëm poet, por edhe luftëtar me pushkë në dorë, atje ku poezia mishërohej me realitetin dhe fatin e popullit në mënyrë tejet origjinale, ku hidhen poshtë ëndërrallat dhe imagjinimet efemere dhe realizohen vegimet poetike, frymëzohet poeti dhe lindin trajtat e kulluara të poezisë në ballafaqim me realitetin, në rrugën specifike të kërkimeve të jetës dhe të njeriut. Autori i „*Humnerës*” jo vetëm shkroi dhe veproi në këtë frymë, por edhe u flijua, dha të vetmen gjë të madhe që ka njeriu dhe poeti — jetën, për liri e humanizëm, për krenarinë e jetës dhe të poezisë.

Shembuj të tillë ka ende, sepse në këtë luftë të madhe atdhetare morën pjesë shumë letrarë. Ata krijuan në kushte të vështira, por megjithatë arritën t'i shprehnin vuajtjet e pashoqe të popullit në luftë kundër pushtuesit fashist, sajuan përjetimet personale dhe ngjarjet e shumta nga realiteti i jetës partizane, nga vitet gjakatare të okupimit, nga ditët dhe motet e heroizmit partizan e popullor. Që të gjitha e shprehin me krenari të veçantë frymën e rezistencës së madhe dhe të revolucionit të përgjithshëm popullor. Prandaj edhe janë dokumente dhe art specifik që rrëfen për një epokë dhe për njerëzit krenarë të saj, për fytyrën e shëmtuar të armikut, për rolin e madh në vendosmërinë e rinisë etj. Ato veçmas dëshmojnë për atë se ç'rol kishte fjala letrare në këto ditë dhe në vazhden e revolucionit përgjithësisht, në thyerjen e vargonjve të së kaluarës dhe hapjen e horizonteve të reja.

S'do mend, një nga shembujt më të shkëlqyeshëm në këtë drejtim është Vlladimir Nazori, me daljen e tij partizan në një kohë kur ishte mjaft i moshuar, me veprën letrare që krijoi në territor të lirë dhe me ndikimin që bëri me fjalën dhe veprimin e tij gjatë këtyre viteve. *Këngët partizane* dhe *Ditari me partizanët* janë dy vepra dinjitoze që rrëfejnë për këtë rrugë e për këtë ndikim

të madh. Vargjet dhe strofat e Nazorit nuk shprehin vetëm ëndrrën e fitores, as vetëm mllefën kundër armikut, por edhe ëndrrat intime lirike, sepse partizanët dinin të luftonin dhe të ëndërronin. Ai paraqiti vuajtjet e popullit, tërbimin fashist dhe gjakpirësinë e ushtashëve dhe të kuislingëve të ndryshëm (*Në Vuçevë, Nëna ortodokse, Abdullahu lëvron, Përpara e Titos* dhe shumë vjersha të tjera). Me fjalë dhe tablo tronditëse nga jeta partizane dhe nga bota intime e tyre.

Fjala poetike e Ivan Goran Kovaçiqit dhe Vlladimir Nazorit përgjithësisht, dhe veçmas ajo e krijuar në LNÇ, gëzoi popullaritet të madh jo si ndonjë pasqyrë e urrejtjes, qoftë edhe kundër armikut, por më tepër si poezi fryme të lartë artistike, të cilën e përshkon edhe urrejtja edhe dashuria, e cila damkos të keqen dhe mbron e lëvdon jetën dhe njeriun i cili lufton për të mirat e saj, për kthjelltësinë dhe mirëvajtjen e jetës.

Por, një popullaritet të ngjashëm gëzon edhe poezia e Oton Zhupançiqit, i cili, ndonëse qëndroi në territor të okupuar, i mplakur dhe i sëmurë, „sërish ia tha këngës së vet me gjith zë”, duke brohoritur si poet i popullit, për liri, duke përkrahur luftën liridashëse të partizanëve pa rezervë, sidomos me vjershat karakterisike si janë *A e di borxhin tënd, poet?, Idilë e Gorenjës, Rekuizicioni, Paj, do ta gjejmë rrugën* etj. si dhe me çdo gjë që shkroi dhe ilegalisht botoi në territorin e okupuar dhe në atë të lirë. Poezia e tij, të cilën e botoi në përmbledhjen *Gjelbrimi i dimrit nën borë* (më 1945) shpreh një vullnet dhe optimizëm të madh jetësor e luftarak, besimin në fitore, në rolin dhe fjalën zëdhënëse të Partisë Komuniste të Jugosllavisë si prijëse, ndonëse vetëm e nënkupton dhe nuk e deklaron emrin e saj, në fuqinë dhe vetëdijen e popullit. Ai me vargje i fton poetët ta ndjekin traditën përparimtare liridashëse, të tregojnë në këto çaste të vështira se cili është borxhi i tyre.

Jo më pak meriton kujdes poezia e Skender Kulenoviçit, tri poema karakteristike, plot ndryshesa poetike dhe me tema autentike të kohës së Revolucionit. Kjo poezi po ashtu dëshmon se „poezia kurrë nuk mejt përpara ngjarjeve të mëdha”, por përkundrazi e shprehu dukshëm dramën dhe tragjikën e kohës. S. Kulenoviç është artist i fjalës së lidhur ngusht me trollin dhe vendin e vet, me fatin e popullit. Çdo gjë që shkroi S. Kulenoviç gjatë luftës apo pastaj la mbresë, por fryma artistike dhe përmbajtja plot dramaticitet e poemës *Stojanka nënë e Knezhopolës* veçohet si rezultat krijues dhe si rrëfim specifik i poezisë së këtij tipi mbi fatin e një nëne, mbi shembëlltyrën heroike të një gruaje, e cila në ofensivën fashiste kundër Kozarës, kundër popullit të Bosnës, humbi tre djemtë, por megjithatë zotohet se po t'i kishte edhe tre do t'ia jepte revolucionit, luftës kundër bishave fashiste. Ajo si nënë dhe si njeri mban në vete tiparet më të spikatura të një nëne malësore, spartane, komponentet më të shëndosha të traditës liridashëse dhe të moralit të lartë, të botëkuptimit mbi jetën, e cila s'ka se si vlen pa krenari e liri njerëzore. Poeti dhe vetë jeta e provojnë këtu në mënyrë konkrete rolin dhe shembëlltyrën e lartë të nënës të thuash në kontinuitet, si në poezinë popullore epike, sepse Stojanka ngjan me nënën e Jugoviçve, jo vetëm pse flijon të bijtë për liri, por pse i tërë kompleksi i ndjenjave të saj prej

nëne shembëllen me atë të nënave gjatë historisë. Në të njëjtën kohë autori rrëfen për heroizmin e luftës partizane, pa romantizëm e glorifikim, por me thelbin e së vërtetës poetike e jetësore, ndonjëherë të vrazhdë, por gjithsesi krenare. Këtë frymë revolucionare e kanë edhe dy poemat e tjera të S. Kulenoviçit *Lauresha* (Ševa) dhe *Letrat e Jova Stanivukut* ndonëse ndryshojnë në mes vedi për nga shtjellimi dhe petku artistik, sepse të *Lauresha* kemi të bëjmë me personifikimin e një shpendi, ndërsa në rrëfimet e Stanivukut me mishërimin e thjeshtësisë popullore, e cila pasqyrohet në zemërbardhësinë e Jova Stanivukut, djaloshtit të dashuruar, me tiparet më të larta shpirtërore të njeriut. Nëna, apo Lauresha, apo Stanivuku — që të gjithë janë mishërim i një vuajtjeje i një lufte dhe i një krenarie njerëzore të gjithë „të përbiruar nëpër vrime të ferrit”, por ngazëllimplotë dhe të-zotët për ta gjetur rrugën e bardhë të ardhmërisë në dashuri të flaktë ndaj vendit, ndaj popullit dhe lirisë.

Branko Qopiqi ishte letrar i afirmuar në mes dy luftërave, tregimtar me koncept origjinal realist në frymën e re. Me flakën e parë kryengritëse ai poashtu shkoi në rrugën e popullit dhe të rezistencës kundër okupatorit. Më parë, temat dhe motivet e prozave të tij ishin njerëzit nën Gërmeç dhe jeta e tyre plotë vuajtje në kushte padrejtësish sociale dhe të varfërisë shekullore në këtë ambient. Gjatë luftës partizane ai, si një nga poetët më të frytshëm, shkroi një varg poezish dhe prozash karakteristike mbi jetën e popullit në kushte të reja, mbi luftën partizane dhe heroizmin e këtyre njerëzve të varfër e të thjeshtë. Paraqiti një varg shembëlltyrash të fëmijëve, të grave të pleqve, si dhe të luftëtarëve, në përpjekjet e tyre mbinjerëzore kundër okupatorit të egër fashist. Duke shkruar thjesht dhe në përkim me atë se „si ia ndiente zemra popullit”, si ëndërronte dhe mendonte, ai u bë një nga poetët partizan më të popullarizuar, poezitë e të cilit shpesh shkriheshin me ato popullore, ngase ai shkroi kryesisht në frymën e popullit dhe e ngriti lartë shprehjen poetike të këtij tipi. Natyrisht, B. Qopiqi shkroi në atë kohë dhe shkruan që tridhjetë vjet pastaj; burimi kryesor e i pashterrshëm i frymëzimit të tij është pikërisht revolucioni dhe lufta, të cilat ai i paraqiti në vepra dhe në përmasa të shumta të poezisë, të prozës, të dramës, të skenarit filmik, të romanit etj. përmes humorit të kulluar apo përmes dramave të fuqishme njerëzore.

Një nga poemat e LNÇ që vlen të përmendet, sepse është vepër e fuqishme dhe e denjë e kësaj kohe, është ajo e Vlladimir Popoviçit *Sytë*. Autori, pjesmarrës i Luftës Nacionalçlirimtare që nga fillimi, shtjellon një tem autentike, e cila i ka rrënjët thellë në tragjikën e jashtëzakonshme të luftës dhe të terrorit e tërbimit të ustasheve në Kroaci. Poeti vështron mbi vorbullën e këtyre ngjarjeve befasuese dhe përsiat për kuptimin dhe moskuptimin e jetës, për krenarinë dhe turpin, për luftën dhe paqen etj. Baza e poemës është jeta e vërtetë, ngjarjet e drejtpërdrejta, terrori dhe tërbimi fashist i ustasheve. Jeta është ferr i vërtetë, sepse njerëzit, pa faj e pa asnjë arsye, i hedhin në greminën e vdekjes, pikërisht si të *Humnera* e I. G. Kovaçiqit. Vriten vajzat e reja, bijat e Gjukan Mashiçit, masakrohet

mosha e re dhe e pastër e tyre; djegin e presin, vrasin e therin ustashët e tërbuar dhe poeti pyet pse vallë, për çka për kë, në ç'emër „njeriu edhe tash si në kohët më të lashta, e mashtron jetën e vet me yje në cep të qiellit”, pse shëmbëlltyra e kësaj bote të shkruhet me gjak e urrejtje në vend të dashurisë dhe bukurisë. Poema anon kah trajtat filozofike, por është e qartë dhe plot mbresë dhe padyshim, element me rëndësi në kompleksin e veprave dhe të fjalës letrare që përkon me revolucionin.

Në mënyrë të veçantë do të mund të flitej për poezinë e Radovan Zogoviqit, apo për veprën interesante letrare të Jovan Popoviqit dhe të pjesëtarëve të tjerë të letërsisë sociale të paraluftës, të cilët, tashti në kushte rrënjësisht të tjera vazhduan me krijimtarinë letrare dhe me luftë në dy fronte, në fushën e betejës me zjarrin e armës, dhe në fushën e ideve dhe të krijimeve letrare ngjashëm si me armë, në luftë për jetën dhe për letërsinë e re.

Nuk mund të mos përmendet këtu vepra e Matej Borit i cili si poet lindi dhe u formua gjatë LNÇ dhe në revolucion. Poezia e tij është e dendur me motive plot mbresë, me tablo e tema të fuqishme nga përpjekjet e popullit sloven „të dënuar me vdekje”, por të pamposhtur dhe pa frikë në luftë kundër fashizmit. Vjershat e tij u shndërruan në këngë e marshe partizane, u përvetësuan nga populli dhe ushtria Nacionalçlirimtare dhe sidomos disa nga to si „Hej brigada”, „Ne marshojmë”, „Do të sulmojmë në mëngjes heret” etj., kishin frymë të fuqishme frymëzuese, ndaj ndikuan dukshëm për ngritjen e moralit të popullit dhe të luftëtarëve, pa marrë parasysh se ç'nivel artistik kanë arritur ato.

Frymë të fuqishme artistike dhe shoqërore ka poema e Jure Kashtelanit *Tifusarët*, një ndër veprat më të dalluara të kësaj periudhe dhe një nga dëshmitë më trishtuese dhe më krenare për LNÇ, për kolonën partizane të stërmunduar jo vetëm nga lufta dhe kushtet e rënda të jetës e të luftës, por edhe nga uria dhe nga sëmundja, nga tifoja e tmerrshme në pikë të dimrit dhe acarit ndjellakeq. Ajo që është më karakteristike për këtë poemë ka të bëjë me dy planet e saj: deri sa rrëfen për tmerret dhe mundimet e kolonës në stuhi „ku as njeri as ujk nuk ka” dhe ku vdekja është aq prezente dhe gllabëruese, poeti gjithnjë, që nga kreu i parë dhe në vazhdë, e ka parasysh vegimin e ardhmërisë, fitoren dhe jetën e lumtur. Kolona e tij e „tifusarëve” është vetëm një nga shumë kolonat e ngjashme që kanë shkelur malet e bjeshkët tona në shtigje të revolucionit, por prometeizmi i saj, vegimi optimist i ardhmërisë që ka autori, këto janë simbole të fuqishme të besimit në fitore, të dashurisë së madhe ndaj atdheut e popullit dhe të tiparit të lashtë që ka populli i cili s'përkulet dot. Poema është sajuar jo si ndonjë përmbajtje e gjerë, por si një sintezë e kulluar e përmbajtjes së „vogël” me domethënie të madhe, me një metodë të veçantë të paraqitjes së atmosferës dhe të vërtetësive jetësore me efekte muzikore, me llojshmërinë e përkimeve të fjalës me muzikën dhe me tablotë e natyrës, të cilat shkrihen në një strukturë fjale revolucionare, fjale të frymëzuar për luftën dhe revolucionin.

Ngjashëm do të mund të flitej për poemën e Sllavko Vukosavleviqit „*Kadinjaça*”, e cila po ashtu dëshmon se „ka kaluar koha e epeve” dhe se tashti është një kohë e re, për nga fryma e zgjimit popullor të thuash e ngjashme me periudhën e romantizmit, përkundër ndryshimeve rrënjësore; kohë e cila nuk e përjashton mundësinë e transponimit epik, por megjithatë është kohë poemash, kohë formash lirike të veçanta, si prore kur është fjala për kthesa të mëdha historike, për revolucionet dhe zgjimin e vetëdijes së popullit, për „formimin e kombeve” dhe afirmimin e tyre, për ngjarje të mëdha në skenën e historisë. S. Vukosavleviqi ia kushton „*Kadinjaçën*” fitores së parë të madhe të lëvizjes, Republikës së Uzhicës, të cilën, si çerdhe kryengritësish, e kishin halë në sy gjermanët dhe çetnikët, ndaj edhe derdhen tërë fuqinë e tërbimit gjakëpirës kundër saj. Në rrebeshin e luftës këtu ranë njëqind e tetëdhjetë punëtorë e djem të rinj, pjesëtarë të batalionit të punëtorëve, por nuk i lëshuan pozitën. U flijuan për idealin e lartë të lirisë, për tokën e lirë dhe republikën e re. Poeti e nderon këtë kujtim, ndaj edhe ua kushton poemën e tij këtyre ditëve dhe këtyre trimave të fortë, të paepur as para vdekjes.

Në secilën nga këto poema, si dhe në çdo vjershë, apo rrëfim lirik të kësaj kohe dëshmohet e vërteta e pamohueshme se njeriu gjithmonë ka arsye dhe shtytje që ta dëshmojë veten dhe kohën në trajta të artit, se poezia me thelbin dhe kuptimësinë e saj është një akt i lartë moral, shprehje e qenies së njeriut dhe imperativ i parimeve morale që ka ai. E tillë është edhe kjo poezi, e lindur në revolucion, karakteristike dhe e fuqishme si pasqyrë e veçantë e tipareve kryesore të lëvizjes dhe karakterit të bartësve të saj: guximit, humanizmit, angazhimit moral, talentit, parimësisë klasore dhe intelektuale etj. Prandaj edhe mund të quhet *poezi* dhe *dëshmi* e fuqishme e një epoke në të cilën pa asnjë dyshim fjala letrare kishte rol të veçantë, gjatë luftës së armatosur kundër okupatorit dhe në vazhden e revolucionit...

Kjo periudhë nuk dha vepra të mëdha në prozë. Edhe ato të paktat që panë dritë, si *Legjendat e vërteta* të Jovan Popoviqit, *Ata të paemër* të Ivan Donçeviqit, *Kurir Loda* i V. Nazorit, *Për fitore* të Jozha Horvatit, proza e Branko Qopiqit nga lufta etj. sado që në to mund të gjejmë sekuenca dhe tablo interesante dhe të fuqishme të atyre ditëve dëshmojnë se kjo prozë artistikisht është e kufizuar, pa fuqi të mjaftueshme letrare dhe pa nivel imanent të artit letrar, para së gjithash për arsye se krijohej në kushte tejet të vështira ato kur „letërsia krijohej në mes zjarreve”, në prezencën e luftës dhe vdekjes që mund të vinte zgabim, kur çdo gjë „shkruhej përmbi gjunj” dhe me ndërprerje aq të shpeshta. Pra, nuk ekzistonte të thuash asnjë mundësi për gjerësinë epike dhe për një shtjellim të koncentruar e të gjerë si e kërkon proza. Megjithatë, edhe proza e këtyre ditëve tërheq vëmendjen dhe është pa dyshim interesante për nga fryma dokumentare dhe autentike, si skicë, fragment, shënim, bisedë e shënuar me pasion apo filizë e sajimit imagjnativ, si përpjekje në luftë kundër pushtuesit, si dëshmi specifike dhe e vërtetë mbi kohën e cila e lindi këtë letërsi, dhe mbi vetë

letërsinë e letrarët që frymëzuan lëvizjen, i dhanë fryte të rëndësishme kulturës, e ushqyen me vepra e me gjak idealin e revolucionit. Sepse, pos të tjerave, në këtë luftë të madhe ranë dëshmorë shumë shkrimtarë e artistë, si A. Cesareci, Hasan Kikiqi I. G. Kovaçiqi, O. Kershovani, O. Perica, B. Axhia, Gj. Jovanoviqi, V. Maslesha, M. Savkoviqi, K. D. Kajuh, Gj. Lopiçiqi, që të gjithë të mirënjohur në letërsinë e paraluftës, si dhe shumë të tjerë anambanë vendit.

Folklori partizan, poezia dhe proza artistike, dramaturgjia, publicistika, ditarët dhe kujtimet e shumta, të gjitha këto dhe të tjerat trajta spontane të fjalës, e dëshmuar dukshëm zgjimin dhe mëkëmbjen e popujve të një vendi, vendosmërinë e popujve në luftë për një jetë tjetër që do të vinte pas kësaj kthese, për njeriun e ri dhe formimin moral dhe ideopolitik më të shëndoshë të brezit të ri, për ngritjen dhe afirmimin e njeriut antifashist dhe humanist e internacionalist. Dhe ky njeri i ri vërtet u lind në kushte të luftës dhe transformimit revolucionar. Fjala letrare pa dyshim e frymëzoi lindjen dhe formimin e tij socialist dhe revolucionar, e ushqe me krenarinë e vet dhe me fuqinë e besimit të plotë në fitore. Natyrisht, po t'i qasemi nga aspekti thjesht artistik e t'i shtrojmë kërkesa rigorozë estetike, do të konstatojmë pa shumë vështirësi se ajo ka mungesa dhe nivel modest. Por nëse e kemi parasysh aspektin tjetër, kohën dhe shqetësimet e saj, misionin specifik të letërsisë në këto ditë, rolin nxitës të fjalës, të vërtetën që ka rrëfyer, atëherë doemos duhet të themi se misioni i saj qe vërtet i lartë dhe kuptimplotë, i mishëruar me idealet, me patosin humanist dhe me qëllimet e larta revolucionare.

3.

Përkundër faktit se karakteristika e këtyre dy fazave nuk është aq cilësia artistike sa synimet e mbara dhe sasia, idetë dhe fryma militante, ato megjithatë lanë gjurmë të dukshme dhe ndikuan, madje në një mënyrë evidente dhe qenësore, në periudhën e letërsisë së pasluftës, madje jo vetëm në një, por në shumë drejtime dhe në letërsitë e të gjitha gjuhëve të kombeve dhe kombësive. Një kohë mjaft të gjatë në të vërtetë mbizotëroi fryma dhe mënyra e të shkruarit sipas konceptit dhe stilit të këtyre viteve. Natyrisht, kjo varej nga talenti individual dhe situata konkrete krijuese, prandaj paraqiten edhe ndryshimet e dukshme dhe intencat e reja të shtjellimit, në përkim me tematikën, botëkuptimin, stilin, realizmin, frymën moderne etj., etj. Krahas ndikimit dominant të letërsisë sovjetike në vitet e para, është i pranishëm edhe ndikimi i letërsive perëndimore, interesimi për Prustin, Xhojsin, Kafkën, Heminguejin, Xhemsin, Tomas Eliotin dhe për bardët e tjera të letërsisë moderne e moderniste. Mirëpo, kjo vjen në vitet kur kushtet për krijimtarinë letrare kanë ndryshuar rrënjësisht, e me to edhe konceptet estetike. Ngadhënjimi i revolucionit socialist, zhdukja e

pengesave për zhvillimin letrar e kulturor, të lirë, në të gjitha gjuhët e kombeve dhe të kombësive, paraqitja e një vargu shkrimtarësh me frymëzime të reja, me metoda krijuese të veçanta, me shtesime letrare dhe me botëkuptime të diferencuara, krijimi i kushteve të përshtatshme për paraqitjen e brezit të ri pa kriterë të ngurta dhe pa dogmatizëm, synim për një transponim letrar më subtil, asociativ, psikologjikisht më të thelluar dhe përgjithësues për nga fryma estetike, njohuritë e reja jetësore dhe tejkalimi i caqeve të deriatëhershme — shtruan një rrugë krejtësisht të re, më të frytshme dhe më të lirë për letërsinë. Konfliktet konceptuale dhe polemikat e mprehta e të vrullshme të asaj kohe nuk e penguan, por përkundrazi e pasuruan letërsinë. Tashti ajo prapë përkon me ngjarjet më dinamike dhe të reja të cilat nuk mund të mënjanoreshin. Temat e luftës vazhduan të mbidominonin dhe kjo merret si një gjë e natyrshme, por autorët filluan të shtjellonin edhe tema të tjera, duke iu drejtuar bashkëkohësisë, realitetit të ri në të cilin gjenden jo vetëm heronjtë por edhe njerëzit që dolën nga lufta, të lodhur, të plagosur shpirtërisht, ndaj përjetonin trauma të ndryshme dhe nuk janë vetëm „personazhe ideale,” por edhe „heronjë të lodhur” ndonjëherë. Patosi heroik mbahet, pastërtia e revolucionit si temë qëndron dhe nuk cenohet, porse filloi të mënjanohet deklarativizmi, të mos pranohet më njëanshmëria e paraqitjes së njerëzve dhe të situatave jetësore jobindëse me sistemin „bardhezi”. Pra, edhe temat dhe njerëzit nga revolucioni dhe lufta edhe të tjerat shtjellohen në një mënyrë tjetër, jo vetëm klasike, racionale por edhe iracionale, jo vetëm realiste por edhe moderniste, neosimboliste etj. që do të thotë me eksperimentime dhe kërkime krijuese, në një mënyrë të reviduar, pa dyshim më të thelluar, apo që synonte të bëhet dhe përditë po bëhej më e thelluar dhe letrarisht më e thuktë. Kjo frymë dhe këto konvulsione shpirtërore në përkim me krijimtarinë u bënë bazë e letërsisë së sotme, faktor i cili kushtëzoi një kthesë tejet të madhe konceptuale, sado që u ruajt dhe qëndron gjithnjë kontinuiteti etik dhe letrar, synimet revolucionare dhe fryma e veçantë progresive e kësaj letërsie. Llojllojshmëria e stileve, pasuria e trajtave dhe e koncepteve ideoestetike, pesha serioze e temave dhe e motiveve të gjurmara me kujdes, gjetja e tyre inventive dhe ndërlidhja fleksibile me traditën krijuese revolucionare, janë komponente të shquara, të cilat dëshmojnë se fjala letrare vazhdon ta kryejë rolin e vet specifik edhe sot, në kushte shumë më të përshtatshme, por në vazhden fare të re, të ndryshuar rrënjësisht nga ana estetike, të letërsisë dhe të frymës revolucionare, bile në synimet e paraqitura krijuese, por edhe në realizime të dukshme dhe të mjaftueshme.

Natyrisht, numri i shkrimtarëve dhe i veprave që kanë të bëjnë me këtë fazë të letërsisë, ku paraqitet revolucioni apo LNÇ është tejet i madh, madje i madh në secilën nga letërsitë e kombeve dhe të kombësive veç e veç, sa që as mund të pretendojmë se mund të analizohen, madje as të përmenden të gjitha në një hapësirë kështu të kufizuar. Mirëpo, mjafton të themi se bartësit e këtyre temave dhe autorët e shumë veprave të rëndësishme janë autorët e mëparshëm, pjesëtarë të letërsisë në mes dy

luftërave apo pjesmarrës në LNÇ dhe të revolucionit filluan të merren si studiues dhe artistë, të cilët e sublimojnë dhe shtjellojnë në vepra përvojën dhe përjetimet e të tjerëve. Pra, do të mund të niseshim nga paraqitja tipologjike e këtyre ideve, për shembull vetëm të revolucionit si Revolucioni Popullor, apo të luftës si tmerr, si negacion, apo si domosdoshmëri, sepse fjala është për Luftën Nacionalçlirimtare etj. Mirëpo, ne nuk na intereson veçmas vetëm vrojtimi letrar i revolucionit si kryengritje popullore as si shpërthim revolte popullore, as Revolucioni si ndeshtrashë e një jete, si takim dramatik i një mentaliteti njerëzor, i cili është ballafaquar me një epokë kualitativisht të re, as revolucioni si tragjikë apo krenari, si dramë e përçarjes dhe e konfliktit shpesh edhe të pakuptimtë, e jo vetëm të arsyeshëm klasor të njerëzve etj. Ne na intereson kompleksiteti i kësaj paraqitjeje me të gjitha këto elemente bashkë, na intereson vërtetësia artistike dhe thellimi psikologjik, kredhja në të vërtetë komplekse dhe në kontradiktat reale të revolucionit dhe të luftës. E këtë mund ta gjejmë te një varg shkrimtarësh serbë, apo kroatë, apo sllovenë malazezë maqedonas, musliman, apo edhe te një varg syresh të kombeve dhe të kombësive. Secili nga këta autorë niset nga e vërteta e përgjithshme, por edhe nga përvoja personale dhe shprehja e këtij fenomini në jetën e popullit të tij. Pastaj, këto tema e motive i gjejmë të shtjelluara në poezi dhe prozë tregimtare, në drama e memoare, në ditarët e shumtë, por edhe në romane vëllimore dhe të një numri vërtet impresiv. Fjala është për projeksione të veçanta dhe prore interesatne, por edhe për një lëndë vërtet të gjerë, mbase edhe të pakapshme si tërësi. Ndoshta mjafton t'i përmendim vetëm disa nga ata të formatit të thuash evropian, te të cilët revolucioni dhe lufta janë tema dominuese, si janë: Branko Qopiqi, Mihaillo Llalliqi, Antonije Isakoviqi, Erih Koshi, Skender Kulenoviqi, Oskar Daviço, Ivan Donçeviçi, Petar Shegedini, Mirko Bozhiqi, Sllavko Kollari, Prezhihov Voranci, Mishko Kranjeci, Matej Bori dhe një varg të tjerësh të rangut tjetër, më pak apo më shumë të frytshëm dhe të angazhuar në këtë drejtim.

Për shembull, shkrimtari malazez, Mihajllo Llalliqi hyn në radhën e shkrimtarëve, të cilët jo vetëm e trajtuan, por edhe e përjetësuan temën e revolucionit dhe të LNÇ. E tërë vepra e tij vëllimore, duke filluar me vargjet militante dhe me tregimet plot veçanti, dhe duke përfunduar me romanet e tij plot realizëm, është e frymëzuar nga ditët dhe përjetimet konkrete dhe reale të revolucionit, nga përvoja e pasur, subjektive dhe objektive, luftarake. Veprat si *Pararoja*, *Tregimet e zgjedhura*, *Dasma*, *Ndjekja*, *Pylli i Lelejit*, *Pranvera e ligë* etj. janë vepra letrare komplekse, artistikisht të përkryera. Në to Llalliqi i transponon revolucionin dhe luftën si dy tema kryesore, të njësuara, në fokusin e së cilave është malësori ngapak patriarkal, njeri i vendlindjes së tij, por natyrisht i përgjithësuar, si njeri qëndresë, guximi, gjeturie, por edhe njeri tragjik dhe fatkeq. Sepse në paraqitjen objektive të këtij autori këtë njeri shpesh e gjejmë jo vetëm kreshnik, por edhe të rënë në kurthin e tradhëtisë, të përllangur nga ndonjë veprim jo burror dhe të ligë, të zhytur në një luftë vëllavrasëse, të

përgjakshme dhe absurde. Pra, ai nuk e glorifikon, por as nuk e kursen kur duhet kritikuar. I njeh të metat që ka dhe i thotë pa ngurrim, me një realizëm të thellë dhe të pakompromis, duke e arsyetuar mbase vetëm me ndonjë pasazh artistik, ngase lufta te njerëzit vetvetiu zgjon shtytjet e errëta, hakmarrjen, vrasjen tinëzore, tradhëtinë. Kjo shihet sidomos në paraqitjen e diferencuar të grupeve partizane, apo të partizanëve si individë në krahasim me turmën e egërsuar të çetnikëve dhe me mjerimin në të cilin kanë rënë ata edhe si individë edhe si kolektiv. Shihet edhe nga simpatia e madhe dhe kujdesi me të cilin ky autor i paraqet protagonistët e veçantë, shembujt më të dalluar të trimërisë dhe kreshnikisë revolucionare, trimat si Tadija Çemerikiqi, karakteri dhe qëndresa e të cilit personifikon karakterin e tërë grupit të partizanëve, të cilët autori i shën si një kategori trimash, por edhe viktimash të rrethanave në të cilat kanë rënë. Për Tadinë, si edhe për ata të gjithë, revolucioni është një domosdoshmëri historike. Në të nuk mund as s'ka pse të dyshohet, sepse revolucioni është i vetmi pohim real, i plotë dhe spikatje e humanizmit dhe krenarisë. Mirëpo Çemerikiqi ndryshon bukur shumë nga Lado Tajoviqi, i mëvonshëm i cili është, revolucionar intelektual, por i lodhur, ngase përjetimet personale tragjike në dashuri e jetë, për shkak se vasha që dashuronte përfundoi tragjikisht në gërmadhat e Beogradit të bombarduar psikikisht e kanë dërmuar, prandaj, nuk ka mjaft fuqi dhe potencial dashurie për ta dashur sa duhet as veten, as Revolucionin, i cili në fakt ishte dashuria e tij e dytë. Peshon rëndë barra e përjetimeve tragjike mbi supet ende jo të sprovuara të studentit, intelektualit revolucionar, të ballafaquar me aq shumë absurditete, ndaj edhe të dobësuar. Kjo edhe më shumë vlen për Niko Doseliqin e romanit *Shkëputja*, apo për të njëjtin personazh të *Pranverës fatkeqe* të paraqitur me veçanti dhe ndryshe në romanin më të mirë të këtij autori *Pylli i Lelejit*. Por, sado që është e përqëndruar te figurat apo protagonistët e veçantë që janë mishërim i fatit të njeriut, Llalliqi na jep edhe tabllo të tëra dhe një dëshmi komplekse dhe tragjike të revolucionit dhe të luftës me të cilat shquan krenarinë dhe madhësinë e fitores.

Në këtë drejtim mbishquhet edhe mbarë vepra e Oskar Daviços, poezia e tij, apo edhe më dukshëm, cikli i romaneve mbi burgimet dhe përjetimet në vazhden e revolucionit, apo mbi luftën dhe aksionet ilegale, si janë ato të Miqës me shokët në romanin *Poema*. Daviço është poet revolucionar dhe prozator revolucionar, i cili temën e revolucionit e paraqet me variacione, herë drejtpërdrejtë herë tërthorazi, në vepra me një fundament të fuqishëm psikologjik dhe artistik modern. E vërteta e revolucionit dhe e vërteta për revolucionin paraqiten në veprën e tij me një kompleksitet e njohuri të rrallë, me erudicion dhe dinamikë psikologjike dhe moral. Prandaj, vepra e tij kërkon një përkushtim të plotë dhe të thellë, ngase kemi të bëjmë me meditime, trajta, asociacione dhe përgjithësisht me një frymë artistike dhe shoqërore të veçantë, të rallë.

Njëri nga njohësit më të thellë të revolucionit dhe të karakterit popullor të tij, me prirje të veçantë për humor, me dashuri të madhe dhe

fisnike për njeriun është poeti, tregimtari dhe romansieri i spikatur i Bosnës Branko Qopiqi, autor i veprave karakteristike si janë *Vesa mbi bajoneta*, *Ofenziva e tetë*, *Shpërthimi*, *Mos u pikëllo roje e bronzit*, *Baruti i shurdhër*, *Kopshti ngjyrë mullage* dhe të një vistre veprash të tjera, i cili gëzon një autoritet të rrallë si shkrimtar i Luftës Nacionalçlirimtare dhe i revolucionit. Zaten as nuk mund të flitet për ndryshesat e paraqitjes së këtyre temave në letërsi pa e njohur dhe pa e pasur parasysh në radhë të parë veprën e tij, sidomos tregimet impulsive dhe të veçanta në shumë aspekte. Veprën e tij e karakterizojnë, në radhë të parë, realizmi dhe bukuria artistike e thjeshtë, drejtpërdrejtshmëria dhe humori i këndshëm, por edhe kredhja e thellë në të vërtetat jetësore specifike që përkojnë me fenomenin e revolucionit dhe të luftës. Prandaj, pos faktit të pamohueshëm se në veprën e tij përgjithësisht kemi të bëjmë me një qëndrim optimist dhe me një dashuri të pakufishme, thellësisht njerëzore ndaj jetës, duhet vënë në pah edhe të vërtetën po ashtu të pamohueshme se motivi i vdekjes është frymëzimi i tij më i shpeshtë. Ndoshta pikërisht ai Qopiqi është shkrimtar, i cili vdekjen e paraqiti aq dukshëm edhe si pasojë tragjike lufte e shkatërrimesh, edhe si fakt të paevitueshëm që shoqëron jetën, që do të thotë se e paraqiti në një mënyrë më të thellë edhe më komplekse. Sepse te ai vdesin edhe fëmijët, edhe gratë, pleqtë, fshatarët, punëtorët, intelektualët, vajzat dhe djemtë, vdesin të vegjlit dhe të mëdhenjtë të thuash ngjashëm, si viktima të tmerrit të luftës, por ngjashëm edhe si luftëtar trima. Ndoshta për këtë arsye edhe hasim te ai aq shumë kreshnik, heronj të natyrshëm. Poeti natyrisht, për këto vdekje masive rrëfen me pikëllim dhe me zemër të lënduar, por nuk bie në pesimizëm, nuk rrëfen me rezignatë. Përkundrazi, ai beson thellë në fitore. Është i vetëdijshëm se vdekja dhe varret e shumta që sheh, dhe i numëron me vargje e rrëfime në prozë, janë parakusht i lirisë dhe i fitores.

Paraqitje të tilla komplekse kemi, kur është fjala për Revolucionin dhe LNÇ si frymëzim, edhe te autorët si Antonie Isakoviqi, Branko Milkoviqi, Velko Kovaçeviqi, Vasko Popa, Mlladen Olaça, Stevan Raičkoviqi, Blazho Shqepanoviqi, Mishko Kranjeci, Miroslav Kërlezha, Mirko Bozhiqi, Ivan Doçeviqi, Hivzi Sulejmani, Esad Mekuli, Enver Gjerqeku, Azem Shkreli, Fahredin Gunga, Ranko Marinkoviqi, Vjekosllav Kalebi, Bllazhe Koneski, Sllavko Janevski dhe sa e sa të tjerë të kombeve dhe të kombësive në Jugosllavi.

Te secili nga këta shkrimtarë mund të gjejmë nga diçka që do të mund të cilësohej si inovim metodologjik, si qasje e veçantë dhe si frymëzim i një tipi vetanak. Sepse Revolucionin dhe LNÇ dhanë mundësi të pakufishme, tejet inspirative për krijimtarinë letrare e artistike, mbase pikërisht për arsye se liria e krijimtarisë dhe qërimi i hesapeve me dogmatizmin dhanë mundësi të mjaftueshme për hetimin e të vërtetave të thella njerëzore në Revolucion dhe të Revolucionit, dhe se ato u paraqitën në vegime të veçanta dhe me koncepte të ndryshme artistiko-letrare. Mirëpo, sado që ndryshojnë metodat e paraqitjes, apo vetë të vërtetat dhe vizioni i tyre, për shembull te shkrimtarët kroatë në krahasim me atë te ata sllovenë, apo te

ata serbë, te ata rusinë, hugarezë apo shqiptarë, sepse kemi të bëjmë me specifikat, me kushte e rrethana të Revolucionit si dhe me ato krijuese të ndryshme, prapëseprapë ekzistojnë karakteristikat e përgjithshme dhe të vërtetat unike të revolucionit të cilat dalin në shesh në të gjitha këto letërsi, te shkrimtarët e koncepteve të ndryshme, madje edhe mund të flitet veçmas për shembull për Revolucionin dhe LNÇ në letërsinë serbe, në atë kroate, në atë të Bosnës e Hercegovinës, në atë maqedone apo në atë malazeze, sikundër që mund të flitet ndaras edhe për Revolucionin dhe LNÇ në letërsinë e hungarezëve, apo të shqiptarëve në Jugosllavi, në atë të kombësisë sllovaqe, rusine, turke, bullgare, rumune etj. etj. porse do t'i gjemë temat dhe motivet, apo më mirë karakteristikat kryesore të thuash të njëjta...

Nuk ka kurrfarë dyshimi se studimi i veçantë i këtij fenomeni, në cilëndo nga këto letërsi, paraqet një interes dhe punë me rëndësi. Mirëpo, një ndërmarrje e tillë do të nënkuptonte punën shumëvjeçare, e cila do të duhej të paraqitet në shumë vëllime, ngase tema është tejet e gjerë, komplekse dhe aktuale për të gjithë, edhe si temë por edhe si bazë, mbase ende jo e studiuar sa duhet, për vazhden letrare, për krijimin e një letërsie të re në përkim me këtë, e cila vërtet ka themele të forta dhe të shëndosha. Shumë punë në këtë drejtim janë bërë dhe po bëhen, por jo çdokund njëllor. Ndaj na mbetet borxh që t'i vihemi studimit më me përkushtim, edhe kur është fjala për frymën dhe ndryshesat artistike, edhe kur kemi të bëjmë me fundamentin dhe kompleksitetin ideor estetik...

Hasan Mekuli

EPOQUE DE LA REVOLUTION ET DE LA LUTTE DE LIBERATION NATIONALE DANS LA LITTERATURE DES NATIONS ET DES NATIONALITES YUGOSLAVE

R é s u m é

Les visés progressives, révolutionnaires dans la littérature des nations et des nationalités commencent à paraître dès mouvement de la littérature sociale, laquelle commence après la Grande guerre mondiale, mais elle atteint sa culmination dans les années trente. Sans doute, cette littérature a inspiré la révolution et L.L.N., ainsi que contrairement la Révolution et la LLN ont inspiré et stimulé le sillon d'une littérature militante, progressive et révolutionnaire des années de la guerre et d'une période assez longue après la guerre. Ainsi, on peut parler de trois composants ou périodes de cette littérature, c'est à dire semblable, ou bien la même par son esprit et par son expression spécifique qu'elle a. C'est pourquoi on la partage en trois chapitres généraux. La premier est le mouvement de la littérature sociale ou bien la littérature de la gauche qui se développa en général dans les années trente et qu'elle a joué un rôle spécifique de stimulation, révolutionnaire, en exprimant les visés d'épris de liberté de la population et surtout de la jeunesse.

Le deuxiem chapitre est compose par la partie de la littérature, laquelle est formée pendant la guerre, dans le territoire libre, et qui quoique écrite dans des conditions spécifiques,

a un vêtement artistique caractéristique et un contenu guerrier typique, c'est pourquoi il éternise l'épopée de la Lutte de Libération Nationale. Enfin, le troisième chapitre, la littérature riche de l'après guerre, inspirée par l'épopée glorieuse de la lutte contre les occupants et des traîtres dont le sillage ne s'est pas arrêté même à nos jours.

Les caractéristiques générales de cette littérature, dans ces trois chapitres sont: son esprit spécial militant, les sujets et les motifs sociaux en général, le récit direct et la présentation réaliste. Quoique l'effet que cette littérature se créa dans tous les genres littéraires, et encore qui est une caractéristique à part, se créa dans toutes les langues des nations et nationalités yougoslaves, c'est à même temps avec le même esprit artistique. Elle possède un complexe visible d'œuvres créées et un grand potentiel de sujets caractéristiques exposés de différents points de vues des auteurs qui s'accordent non seulement avec les différentes nations mais aussi les différentes contrées où se sont passés les événements présentés, puis aussi, avec les différentes générations des participants de la guerre lesquelles s'occupaient de la littérature, ou des générations après, lesquelles ont suivi une autre méthodologie du processus littéraire, et qui ont regardé la période de ces trois décades soit directement, comme participants et témoins, soit indirectement comme hommes scientifiques et artistes qui regardent d'après les connaissances acquises indirectement, mais dans les deux cas il l'ont présenté avec consécration.

Evidemment cette littérature fait partie dans un cercle plus large de la littérature mondiale de ce type. Les auteurs qui l'ont créée sont nombreux. Sans doute, en tête de la longue liste de ces auteurs en Yougoslavie, se trouvent les principaux, tels que: Miroslav Krleža, A. Cesarec, I.G. Kovačića, V. Nazor, B. Čopić, M. Lalić, O. Davičo, mais il y a beaucoup d'autres, de l'époque nouvelle qui dans de différentes langues des nations et des nationalités, ont suivi la tradition de la littérature sociale et encore dans l'esprit militant de la période de la LLN. C'est pourquoi, cette littérature a donné de grands résultats et artistiquement importants, qui sont des images les plus fidèles de la vie humaine et de la population entière de la Yougoslavie.

Bien sûr, ceci n'est pas la seule cause qui pousse les hommes scientifiques de rechercher et de séparer les œuvres de leurs aspects différents. Dans les trois périodes de cette littérature, notre époque est englobée et exposée avec complexité, et à cause de cela elle est digne pour faire des recherches et étudier avec consécration.

The first part of the report deals with the general situation of the country and the progress of the war. It mentions the various operations and the state of the army. The second part contains a detailed account of the military operations and the results of the campaigns. The third part discusses the political and administrative aspects of the war, including the role of the government and the public opinion. The fourth part concludes with a summary of the achievements and a look towards the future.

The second part of the report provides a more in-depth analysis of the military strategies and the tactical decisions made during the campaigns. It also touches upon the logistical challenges and the impact of the weather on the operations. The third part of the report is dedicated to the political and diplomatic relations, highlighting the international context of the conflict. The final part of the report offers a critical assessment of the military and political leadership, as well as recommendations for future actions.